**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

02 **Nr.** 060/03-28463 **dt.** 17.06 **2022**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **24.06.2022** (E Premte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 30.05.2022.
2. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit për periudhën, 2022-2030.
3. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme bugjetore 2023-2025.
4. Propozim Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928,të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SHA në Drenas-Gllogoc.
5. Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.
6. Raporti i auditimit të Komunës së Gllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31,dhjetor 2021.
7. Të ndryshme.

Drenas, 17.06.2022

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/04-28470 dt. 17.06 2022

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **30.05.2022**

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë.**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt.27.04.2022
2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"
3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas .
4. Njoftim për Qarkoren buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
7. Raport lidhur me mbarëvajtjen e projektit ''Komuna për të rinjtë" në Komunën e Drenasit
8. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimeve 02 Nr.400/01-13247 dhe 02 Nr.400/01-13251,të datës 24.03.2022.
9. Të ndryshme.



Të hënën është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 13 pika për rend dite.
Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, përfaqësues të OSBE-së, Xhavit Drenori, Arben Nika, dhe një qytetar.

Para se të filloj seanca kryesuesi kërkoj një minutë heshtje me nderim për përvjetorin e rënies se Heronjve Rasim Kiqina dhe Ragip Halilaj, si dhe për ndarjen nga jeta të ish presidentit të Shqipërisë z.Bujar Nishani njëherit edhe qytetar nderi i Komunës së Drenasit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari-** pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal, ku theksoj se u shtua në rend dite Propozim-vendimi për Shfuqizimin e Vendimit Nr. 02-035-18372 të datës 27.04.2022 dhe Diskutimi i Raportit të Sistemit të Menaxhimit të Përformancës të vitit 2020 Drenasit.

**Egzona Tërdevci,** pati vërejte të rendi i ditës, propozim vendimet për rendin e ditës nuk po na sjellin me kohë, dhe propozim vendimet e fundit na janë dërguar me dt. 27.05.2022 pra vetëm tri ditë më para seances të rregullt duke pas parasysh që edhe kanë qenë ditë vikendi, po ashtu kur po ka shfuqizime të vendimeve bazuar në vendimet e MAPL-së gjithmonë është dashtë me na e sjellë edhe vendimin që e ka dhënë apo shkresa që e ka dhënë MAPL-ja në mënyrë që ta kemi të qartë se pse po shfuqizohen vendimet, po ashtu ti kushtohet një rendësi shtesë përpilimit të propozimeve që të mos kemi çdo seancë të paktën një vendim tonin të shfuqizuar po ashtu është shumë e rëndësishme për t'i kontribuojmë transparencës të

publikohen në ueb faqen e komunës gjitha vendimet që dalin nga Kuvendi i Komunës si dhe vlefshmëria e tyre nga ana e MAPL-së, sepse e njëjta nuk është duke u bërë aktualisht.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**, çdo propozim vendim për shfuqizim të vendimit që e sjellë MAPL-ja jemi të detyruar me e sjellë në seancë brenda 30 ditëve, po të kalojnë 30 ditë ne mund t'i humbim grandin e përformances, sepse nëse nuk i shfuqizojmë vendimet të cilat nuk janë në pajtim me ligjet.

**Egzona Tërdevci,** nuk është halli pse po i sjellin propozim vendimet për shfuqizim por neve po na duhet edhe shkresa që po ua dërgon ministria, ta dina edhe ne si asamblist se pse po shfuqizohet një vendim nuk mjafton vetëm arsyetimi pse MAPL-ja e ka kundërshtu, kërkoj që me na sjellë edhe shkresat e MAPL-së sepse të njëjtat nuk i gjejmë të publikuara në ueb faqen e komunës.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**, çdo vendim jemi te obliguar për ta publikuar edhe në ueb faqe, e keni propozim vendimin dhe arsyetimin e tij.

**Labinot Halilaj,** në propozim vendim tregon se për cilin shfuqizim të vendimin bëhet fjalë dhe në arsyetim e tregon arsyetimin se ku është në kundërshtim vendimi.

**Drejtoresha për shërbime publike dhe emergjente-Lumnije Krapi,** lidhur me vendimin që po diskutojmë kam kërkuar që ky vendim te jete valid deri në formimin e grupit konsulent që do të behet nga "Gizi" Gjerman për vlefshmërinë e planit të menaxhimit të mbeturinave kështu që ministria e ka paraparë të arsyeshme meqenëse është formuar grupi konsulent ka kërkuar që vendimi të shfuqizohet.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës se bashku me dy pikat shtesë te cekura me lartë, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.03.2022.**

**Egzona Tërdevci,** në faqen e tetë të procesverbalit thuhet se për piken e dytë prezent në seance kanë qenë 22 veta dhe 15 veta kanë votuar (për) kësaj pike, ne atë ditë kemi deklaruar se e lëshojmë sallën, nuk rrimë në këtë pike dhe nuk keni pas të drejtën me na numërua si kuorum, ju atë ditë keni tentuar me manipulua me vota për ta shfuqizuar vendimin e pikës dytë, me vetëm 15 asamblistë në sallë keni tentuar t'i paraqitni si 16 që kanë votuar manipulim ky i cili nuk ju ka lejuar as nga ne si opozitë po as nga vetë anëtari i grupit tuaj po ashtu tek faqe 11 të pika e pestë aktvendimi i vitit 1988 kur votohet propozimi i parë në seance thoni se janë 14 vota (për) 13 kundër dhe 1 abstenim pra i bije se janë 28 asamblistë në sallë prezent ndërsa në procesverbal e keni shkruar kanë qenë prezent 27 anëtar 14 kanë votuar (për) e 13 kundër, nga ajo që unë i kam evidentuar atë ditë kanë munguar 4 anëtar që i bie se kanë qenë 27 anëtar, a keni tentuar atë ditë me manipulua në numra e këtë me e rregullua në procesverbal apo cili është sqarimi juaj për këtë pjesë.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** në asnjë mënyrë nuk do lejoj të bien gabime te tilla, këto munden me qenë gabime teknike, do ta përmirësojmë procesverbalin.

**Mehedin Salihu,** unë i kam bërë tri pyetje dhe është nxjerrë vetëm një koncept i asaj çka kam thënë dhe jo pyjet konkrete, as nuk ceket çka kam pyet dhe as nuk ceket përgjigjja.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 14 anëtar, kundër 10 anëtar, 1 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"**

**Drejtoresha për Sherbime publike dhe emergjente-Lumnije Krapi,** në bazë të ligjit për ndërmarrje publike neni 5 pika 5.2 ligji për ndërmarrje publike, kur një komunë është aksionare i një ndërmarrje publike lokale të drejtat e saj aksionare do t'i ushtroj një komision komunal i aksionareve i cili përbëhet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtar tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës, për ketë qellim komisioni komunal i shoqërisë aksionare ka të drejtë të veproj në emër të komunës përkatëse dhe duhet të veproj me ligjin për shoqëri tregtare. Duke u bazuar se anëtaret e legjislaturës paraprake meqenëse nuk kanë më mandat duhet të emërohen dy aksionar të ri.

**Arbër Halilaj-** po flasim për një komision të një ndërmarrje e cila sidomos vitin e fundit ka pasur përformancë të dobët në aktivitetin e saj ditor gjë që ka rezultuar me pakënaqësi dhe ankesa të shumta të qytetareve. Para se të vendosim për propozim vendimin lidhur me formimin e komisionit komunal të aksionareve të ndërmarrjes publike "Pastrimi" i cili komision është shumë i rëndësishëm përderisa prej tij mbikëqyret nga ana e komunës puna dhe përformanca e bordit dhe e ndërmarrjes si tërësi kisha kërkuar që ne seancën e radhës ta kemi një raport të detajuar të veprimtarisë dhe përformances se ndërmarrjes "Pastrimi" deri në momentin kur po diskutojmë. Kompania për mendimin tim ka dështuar sidomos në menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave në komunën tonë shërbim ky i cili në masë të madhe është paguar me rregull nga qytetaret mirëpo nuk ka marrë në kthim shërbim të kënaqshëm. Duhet ta kemi parasysh se ke po e propozojmë në këtë komisioni nga fakti se jemi para nje propozim vendimi që hap fazën e tranzicionit të këtyre shërbimeve nga ndërmarrja "Pastrimi" tek ndërmarrja e re publike lokale të cilën duhet ta formojmë sa më shpejt në të mirë të qytetarëve.

Kryesuesi kërkoj nga grupet parlamentare propozimet për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"

**Bekim Lestrani,** grupi kuvendar i PDK-së propozon për anëtar të komisionit Malsore Cakiqi.

**Azemine Bujupi-Gjoka,** grupi parlamentar i DD-së propozon për anëtar të komisionit Mergim Pirrakun.

Kryesuesi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike "Pastrimi"** me përberje të komisionit prej 3 anëtareve, nga ekzekutivi: Lumnije Krapi nga kuvendi Malsore Cakiqi dhe Mergim Pirraku. Prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, 1 kundër, dhe 1 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për nisjen e proceduarve për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas .**

**Drejtoresha për Shërbime publike dhe emergjente, Lumnije Krapi**- në bazë të ligjit nr 04/L-111 për ndryshim të ligjit 03/L-087 për ndërmarrje publike dhe në bazë të rregullores 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjes publike lokale pjesëmarrja e komunave në borde të drejtoreve të ndërmarrjeve rajonale të ujit komuna ka të drejtën për të krijuar ndërmarrje publike lokale në pajtime kriteret e përcaktuara më akt nënligjor të qeverisë, kriteret duhet të përfshinë kërkesa të ndryshme për qëndrueshmëri operacionale dhe financiare pra në bazë të këtyre ligjeve është kërkuar që të fillohet me procedura për formimin e ndërmarrjes komunale në Drenas që të merret vendim për nisjen e procedurave. Duke marrë parasysh rekomandimet që janë dhënë në KPF-ca hapat duhet bërë në vazhdim janë: hapi parë ose procedura e par fillestare është propozim vendimi për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, (NPL) në Drenas, hap tjetër është vendimi për themelimin e grupit punues për plotësimin e dokumenteve për themelimin e e ndërmarrjes publike në Drenas, hapi i tretë grupi punues që do të themelohet në kuvendin e ardhshëm detyrat e grupit punues është kompletimi i dokumentacionit për hartimin e politikave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale në Drenas. Raportet nga grupi punues lidhur më plotësimin e dokumenteve për themelimin e ndërmarrjes publike si emërtimi i ndërmarrjes publike dhe logo-ja. Të gjitha raportet që do të hartohen nga gupi punues do të behet një kerkesë në Ministrinë e Planifikimit dhe Mjedisit Hapësinor për themelimin e ndërmarrjes publike me vendimin që do të merret sot për themelimin e ndërmarrjes lokale në Drenas, raportin për qëndrueshmëri financiare, plani i biznesit për një vit kalendarik, garancioni mbi qendrushmerinë financiare dhe orgonorgami i ndërmarrjes.

**Arbër Halilaj,** kushti kryesor për rritjen dhe zhvillim për prosperitetin e Drenasit është forcimi i ekonomisë dhe aktivitetet tjera shoqërore që krijohen vende pune dhe vlere të shtuar, përmes idesë dhe projekteve të përgaditura në mënyrë kualitative ne do të mund të zgjidhin disa nga problemet dhe mangësitë e komunës tonë të rrisim cilësinë e jetës dhe të hedhim themelet për një të ardhme të qëndrueshme të komunës sonë. Sot e kemi para vetes një propozim vendim për themelimin e ndërmarrjes publike lokale që duke qenë edhe pik programore e GRREN për Drenasin për mua është pika me e rëndësishme që e kemi diskutuar deri më tani në këtë asamble. Përkrahi idet dhe projektet e qëlluara nga kush do që realizohen do ta përkrah dhe do ta votoj këtë vendim pa hezitim duke u angazhuar me ide dhe sugjerime në qdo hap të procesit të themelimit të MPL-së. Ndërmarrja publike lokale duhet të themelohet me synimin parësor që t'i menaxhoj shërbimet komunale në mënyrë më efikase. Qëllimi duhet të jetë të zvogëlojmë sasinë e mbeturinave, të arrijmë objektivat e riciklimit të tyre si dhe të paguajmë me korrektësi për grumbullim e mbeturinave shtëpiake për sasinë e dorëzuar, duhet të të synojmë një sistem të mbyllur të menaxhimit te mbeturinave nga MPL-ja për të zvogëluar sasinë e tyre të transportuar në deponi dhe kështu të ulim kostot dhe të rritim mundësinë për shfrytëzimin e mbeturinave të klasifikuara si lëndë të parë ku duhet të bashkëpunojmë më komunitetin dhe administratorë të fshatrave. Potencoj dhe njeherit sugjeroj se gjatë procesit te themelimit të MPL-së komisionit të aksionareve, bordit dhe dokumentet tjera legale të saj te kemi parasysh zgjerimin e fushe veprimtarisë së MPL-së dhe jo kufizimit e 3-4 aktiviteteve që janë të cekura në këtë propozim vendim. Fushe veprimtaria e saj duhet të mundësoj shtimin e numrit të stafit dhe duhet të përfshij këto aktivitete: menaxhimin e mbeturinave deri në ndarjen e tyre për riciklim, aktivitetet e mirëmbajtjes dhe kujdesi ndaj shesheve parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, menaxhimin e vend parkingjeve në pronësi të komunës, mirëmbajtjen e fondit drunor urban krasitjen e tyre,

përkujdesjen e përmendoreve brenda dhe jashtë qytetit si dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmoreve, mirëmbajtja e varrezave të qytetit, shtimi i sipërfaqeve të gjelberta, kultivimin e mbjelljeve të luleve dhe drunjtëve dekorues, mirëmbajtja e rrugëve lokale riparimin dhe evitimin e gropave, pastrimi i rrugëve dimrit dhe verës me ujë, mirëmbajtja e hapësirave të përbashkëta e objekteve banesore kolektive mirëmbajta e institucioneve publike, mirëmbajtja e ndriçimit publik, mirëmbajtja dhe menaxhimi i tregjeve, dekorimi i qytetit për festa etj. Me miratimin e këtij propozim vendimi ne i hapim rrugën që Drenasi ta ketë ndërmarrjen e vet publike e cila hap vende të reja të punës e cila ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien socio-ekonomike të banoreve, ky vendim dëshmon qartë se kemi shumë më pak dallime se sa që mendojmë dhe me përkushtim dhe angazhim të sinqerte mund të implementojmë vendime dhe projekte në të mirë të qytetareve tanë.

**Egzona Tërdevci,** në emër të grupit të LVV unë deklarohem se në parim nuk jemi kundër që të themelohet një ndërmarrje lokale për menaxhimin e mbeturinave, por paraprakisht na duhet një analizë buxhetore se si pritet të përformojë kjo ndërmarrje sa do t'i kushtojë komunës tonë themelimi i saj dhe cili do të jetë impakti që do të ketë kjo ndërmarrje në buxhetin e komunës tonë. Kemi frikë se pa e analizuar mirë se nëse kjo ndërmarrje i leverdis komunës tonë në aspektin financiar ne po e ngarkojmë komunën me një ndërmarrje e cila do t'i bëhet barrë në të ardhmen. Unë propozoj në emër të grupit tonë që këtë pikë ta shtymë për një faze tjetër kur ne kemi një analizë të qartë për funksionimin e kësaj ndërmarrje lokale.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** kërkoj që me e votua ketë pikë të rendit të ditës, nuk jemi vetëm ne se po e marrim këtë vendim janë edhe komunat tjera. Kompania nuk po funksionon, nuk mund të dërgojmë aksione diku ku na nuk marrim shërbim, komuna e ka për obligim për me e themelua kompaninë dhe ne do ta themelojmë, ndërsa për mirëmbajtjen e varrezave është agjencioni për kompleksin e memorialëve është përgjegjësi e tyre, ndërsa menaxhimin e varrezave të qytetareve sigurisht mund ta kemi edhe si fushëveprim.

**Albulena Saliuki-** meqë qëllimi i themelimit të ndërmarrjes publike do të jete funksionale në komunën tonë do të ndikojë ne mirëmbajtjen dhe në menaxhimin sa më të mirë të hapësirave publike e shoh të nevojshëm dhe shumë të arsyeshëm që të votohet ky propozim vendim.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Njoftim për Qarkoren buxhetore 2023/01, MFPT dhe Qarkorja Interne e Komunës së Drenasit.**

**Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku-** i njoftoj në pika të shkurtra sa i përket qarkores buxhetore e cila qarkore i cakton kufijtë e jashtëm të buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe projeksionin e buxhetit për vitin 2024-2025. Sa i përket kufijve të parë të cilët i kemi marrë me qarkoren e parë buxhetore ju njoftoj se Komuna e Drenasit për vitin 2023 parashihet të ketë buxhet 18.154.892 € ndërsa projeksionin për vitin 2024 me shumë prej 19.421.386 € dhe projeksionin për vitin 2025 parashihet buxhet prej 20.191.418, kjo është sa i përket buxhetit dhe kufijve të jashtëm buxhetor, është një buxhet shumë më i adh se sa vitet e kaluara.

**Arbër Haliaj-** kërkoj një sqarim si interferon vendimit i sa po e morëm për ndërmarrjen publike lokale në projeksionet buxhetore që i ceku drejtori?

**Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku-** ky buxhet i përcakton vetëm kufijtë e jashtëm buxhetor për Komunën e Drenasit, hapat që i parashtroj drejtoresha për formimin e organizatës komunale për mbledhjen e mbeturinave i pati tetë hapa të cilët marrin kohë derisa të aprovohen dhe ne do të parashohim projeksionet për vitet 2024-2025 nuk besoj se do të kemi pengesa në hartimin e statutit rregullores aprovimit të vendimit që sapo e morët organizimin e organizatës komunale për mbledhjen e mbeturinave.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** kjo merr kohë, ne nuk mundemi me shku me procedura të gjata, ne ndajmë buxhet për këtë qellim.

**Labinot Halilaj,** ligji mbi financa dhe shpenzimet publike e mundëson edhe nëse nuk ka mjete të planifikuara për një çështje të caktuar sikur se këtë që e morëm.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për rialokim të mjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.**

**Egzona Tërdevci,** pati dy pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë Arsim Haxhiun, a mendoni se ambulanca që është aktualisht i posedon QKMF-ja janë të mjaftueshme, unë personalisht kam përvojë kur emergjenca është vonuar shumë për raste urgjente kur ne i kemi thirrur kur po ashtu ka pas raste kur pacient janë udhëzuar që me vetura private t'i drejtohen QKUK-së për shkak se QKMF-ja nuk ka pas kapacitete profesionale që t'i ofroj shërbim në QKMF-në tonë. Po ashtu kërkoj një sqarim lidhur me pajisjet që do të blihen me shumën prej 140 mijë euro e kam shikuar që është pajisje për rëngën por kërkoj sqarim se për çfarë pasojë saktë bëhet fjalë, meqë keni konsideruar se pajisjet e tilla janë më të nevojshme se autoambulanca.
A mundemi me ditë se kur do të hapet thirrja tjetër për subvencione në fushën e shëndetësisë përkatësisht për organizatat që ofrojnë ndihmë për personat me nevoja të veçanta, e kemi kërkesë nga HANDIKOS që ta drejtojmë këtë pyete tek ju, meqë i kam shikuar dokumentet të faqja e komunës mirëpo një thirrje të tillë nuk e keni publikuar ende.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** asnjë shqetësim që e ngrite nuk lidhet me piken e rendit të ditës, e ceke që është për blerjen e pajisjeve rëngën pra është destinim nga mjetet për mos me bërë blerje dy vjeqare me e bërë një vjeçare mjetet që janë të parapamë për autoambulanca me i kalu për këto pajisje moderne të cilat hyjnë në shërbim të qytetareve. Sa i përket shërbimeve që qytetaret orientohen ose kërkohen me shku me makina të veta, asnjë qytetar që ka nevojë emergjente me e dërgua në QKUK nuk shkon me makinë të veten shkon me autoambulancë, gjithë qytetaret që kanë nevojë i dërgojnë me autoambulanca. Shqetësimet e tjera mundeni me i ngrit të pika tek të ndryshmet.

**Mehedin Salihu,** qka nënkupton me pajisje specifike, unë e kam të qarte mirëpo është mirë me e sqaru për opinionin, autoambulanca kemi mirëpo nuk janë me standarde ose shumica nuk janë me standarde kështu që edhe për autoambulanca është nevoja.

**Drejtori i shëndetësisë Arsim Haxhiu,** propozim vendimi është një kërkesë që ka ardh përmes një shkrese të këshillit profesional të qendrës kryesore të mjekësisë familjare e cila kërkon vetëm rialokim te mjeteve në kuadër të mjeteve dhe shpenzimeve që i ka kujdesi parësor shëndetësor në projektin e pajisjeve mjekësore i cili është në kuadër të planit dhe zhvillimit komunal strategjik të kujdesit parësor shëndetësor të gjashtë pikave të saj të cilat pika duhet të kenë kujdes në çështjen e zhvillimit të përgjithshëm bazike shëndetësorë duke

marrë parasysh se duhet të plotësojmë tri lloj kriteresh duhet ti plotësojmë qind për qind kriteret bazike, duhet të plotësojmë së paku 70% të kritereve optimale dhe 40% të kritereve të se ardhmes, ky projekt qëllimi i vetëm i saj është të plotësohet me buxhet në mënyrë që të behet projekt një vjeçar dhe jo dy vjeçar. Ndërsa sa i përket kapacitete të autoambulancave për momentin janë të mjaftueshme për ketë vit, jemi në fazën e planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.**

**Arbër Haliaj-** para vetes kemi një kërkesë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pavarësisht se kërkesa është tejet e paqartë në formulim dhe në konstatimin e parashtruesit të kërkesës ne duhet që ta shqyrtojmë me vëmendje, udhëzimi administrativ nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në neni 1 Për mbrojtjen e tokës bujqësore si pasuri kombëtare me interes të përgjithshëm është përcaktuar që ajo mund të shfrytëzohet vetëm për qëllime bujqësore. Përjashtimisht ajo mund të shfrytëzohet për qëllime tjera vetëm kur kjo është përcaktuar me Ligjin për Tokën Bujqësore. Udhëzimet Administrative të nxjerra sipas tij dhe Ligjit për Planifikim Hapësinor. Pra token bujqësore e konsideron pasuri kombëtare.
Neni 2 pika 2.1 nen a) Ndërrimi i destinimit – Nënkuptohet nëse toka më nuk shërben për qëllime bujqësore për shkak të ndërrimit të shfrytëzimit të tokës. Ndërtimi i objekteve të cilat shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore do të konsiderohen si ndërrim destinimi. Pra vetëm ndërtimi i objekteve bujqësore, jo restauronte, shkolla private, objekte fetare, depove tregtare etj do të konsiderohet si ndërrim destinimi siç e kemi edhe kërkesën e parashtruar por i cili nuk paraqet një projekt të kompletuar që e arsyeton ndërrimin e destinimit çka pëson pas atij vendimi eventual. Ky propozim vendim është i mangët me informata përcjellëse. Kërkoj që kryesuesi të na siguroj për seancën e radhës një listë me proat që janë dhënë në shfrytëzim ose iu është ndërruar destinimi e janë shfrytëzuar për qëllimin apo investimin në të cilën janë kërkuar, pra cila pronë kujt iu është dhënë dhe qëllimi për çka përdoret tani pas ndërrimit të destinimit. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore dhe tokave pyjore kërkon leje të veçantë nëse toka përkatëse bujqësore gjendet jashtë kufijve të planit hapësinor.
Neni 3. Procedura administrative për ndërrim të destinimit fillon me kërkesën shkruar dhe të nënshkruar të parashtruesit të kërkesës. Kërkesa dorëzohet në komunë në të cilën gjendet toka bujqësore përkatëse dhe i drejtohet organit përgjegjës për planifikim.
Parashtruesi i kërkesës për ndërrimin e destinimit duhet të paraqes informatat dhe dokumentacionin si vijon:
a)Planin e lokacionit në përpjesëtim 1/500;
b)Pozitën dhe numrin e parcelave dhe ndërtesave të afërta;
c)Dëshminë e pronësisë, përmes certifikatës së pronësisë nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme ose dëshminë e të drejtës së shfrytëzimit të tokës, përmes pëlqimit të pronarëve ose kontratës që i mundëson parashtruesit të kërkesës të bëjë kërkesë për ndërrim të destinimi;
d)Përshkrimi i hollësishme e projektit, përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me ujin, rrymën elektrike, lidhjet e kanalizimit dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe sistemet e afërta të ujitjes;
e)Deklarata komunale për lidhjen e mundshme në infrastrukturën teknike;

f. Parashtruesi i kërkesës do të deklaroj se ndërtimi i propozuar duhet të bëhet në lokacionin për të cilin ka parashtrua kërkesë pasi që ajo tokë nuk shfrytëzohet për bujqësi dhe/ose nuk ka tokë bujqësore të klasës më të ulët se toka për të cilën është kërkua ndërrimi i destinimit ose ajo nuk është e përshtatshme për ndërtim;
g)Në rast të kërkesës për ndërrim të përkohshëm të destinimit, duhet të dorëzohet projekti për ri-kultivim, sipas Udhëzimit Administrativ për Ri-kultivim të Tokës Bujqësore.
Dokumentet e kërkuara sipas paragrafit 3 Pikat a), c), d) dhe g) të këtij neni, duhet të dorëzohen në tri kopje. Pra shkaku i kërkesës se mangët me dokumente sipas nenit 3 unë e kam te pamundur të aprovoj kërkesa te tilla të pa kompletuara kështu që do të votoj kundër me kërkesën shtesë që kjo pike e rendit te ditës të bartet në seancat e radhës.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** kërkesa për ndërrim destinim të pronës, prona destinimi i cili nuk iu ka ndërruar prej vitit 74 ka qene një pronë e cila u përdor si objekt ndërtimor gurore gjatë kohës kur u shtru rruga Drenas-Skenderaj, prandaj kemi pas edhe probleme me kërkuesin e lejes për shkak sepse në dokumente na del se është pronë bujqësore e kategorisë së tretë dhe pas verifikimit të situatës dhe dokumenteve që i kemi ne e kemi sjellë në kuvend për me ia nderru destinimnin pronës sepse kjo pronë prej vite është pronë ndërtimore, qëllimi se ka kërkon kërkuesi ose pronari i pronës me ndërtua është çështje e tij personale, janë procedura tjera pas kësaj, por ne kërkojmë që te lejohet ndërrimi, ju ftoj ta votoni për destinimin e kësaj prone.

**Arbër Haliaj-** pavarësisht kush e ka perashtru kërkesën unë jam për këso investime mirëpo që të mos krijojmë procedonte kërkoj që të jetë dokemtacioni i kompletuar siç po e kërkon neni 3, unë nuk e kam parë që është i kompletuar në atë mënyrë siç po kërkohet ne nenin 3 të udhëzimit për ndërrim të destinimit.

**Egzona Tërdevci,** i kemi disa paqartësi lidhur me pikën në fjalë, fillimisht mungon ortofoto për çështjen në fjalë, është paraqit vetëm një skice për neve që nuk jemi nga fusha e ndërtimtarisë nuk i kuptojmë kish qenë e nevojshme me pas edhe një ortofoto me pas se si duket vërtetë prona, pati edhe disa pyetje tjera: a është bërë vlerësimi i bonitetit të tokës, a është konstatuar se gjendja e tokës është vërtetë siç përshkruhet në kërkesën e parashtruesit, si dhe në bazë të parashtruesit të kërkesës është jashtë planit hapësinor, a është dhënë pëlqimi urbanistik për ndërrimin e destinimit të përdorimit të kësaj toke, është dashur te na sjellët edhe vlerësimi i tokës që parashtruesi i referohet që e ka marrë nga një laborator me ekspert të bujqësisë, po ashtu na duhen sqarime nëse vërtetë është vizituar dhe është vlerësuar në teren nga ekspertet komunal kjo tokë siç ka thënë z.Bazaj po vlerësoni nga shpati.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** gjitha të dhënat i keni në propozim vendim ju ftoj ta votoni.

**Mehedin Salihu,** nuk e dij si ka mbet ajo tok bujqësore që hiq nuk ka lidhje me bujqësi, është një vend kodrinor, dhe se dij pse po e diskutojmë kaq gjatë.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, 5-kundër, 2-abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7.Raport lidhur me mbarëvajtjen e projektit ''Komuna për të rinjtë'' në Komunën e Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime, kryesuesi hapi diskutimin për piken e tetë të rendit të ditës:
**8. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimeve 02 Nr.400/01-13247 dhe 02 Nr.400/01-13251,të datës 24.03.2022.**

**Drejtori i Financave, Shyqiri Bublaku-** i njoftoj se projektet te cilat janë paraparë në buxhetin e vitit 2022 në këto dy drejtori kanë kaluar në rezerve buxhetore për shkak se natyra e emërtimit të projektit ka pas të bëjë me mallra dhe shërbime dhe kjo ka mbet ne rezerve buxhetore, drejtoritë të cilat nuk munden me i shfrytëzua projektet të cilat i kanë paraparë kanë kërkuar se këto të barten në mallra dhe shërbime mirëpo MAPL-ja ka kërkuar që këto projekte të mbesin prape si rezerve buxhetore dhe mos të barten ne mallra dhe shërbime.

Pas sqarimit që u dha nga drejtori, kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, 0-kundër, 4-abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: 9. Propozim-vendimi për Shfuqizimin e Vendimit Nr. 02-035-18372 të datës 27.04.2022

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, 0-kundër, 0-abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Diskutimi i Raportit të Sistemit të Menaxhimit të Përformancës të vitit 2020 Drenasit.**

**Egzona Tërdevci,** të grandi i përformances të dokumenti që është për demosin e kam shikuar iu ka kërkuar një sqarim për projektet që doni me i realizua, a mund ta dimë se cilat projekte synohen të realizohen përmes mjeteve që i keni fituar nga grandi i përfomances, po ashtu ditën kur e keni marrë rezultatin nga MAPL-ja në postimin që e keni bërë në facebook keni thënë se llogaritni si komuna e tretë për përformancë me arsyetimin se janë dy faktor që kanë ndikuar për t'i humbur piket tjera, sipas jush dy faktorët që kane ndikuar që t'i humbim piket tjera nga vlerësimi i përformances është mungesa e transmetimit online të seancave për shkak të covid-it si dhe mos dalja e zyrtareve tatimor në vendin e ngjarjes. Nga tabela që na keni dërguar si material prej këtyre dy faktorëve i keni humbur 11 pikë mirëpo janë 19 pikë të humbura në elemente tjera, keni humbur pikë nga diskutimi i gjetjeve të raporteve të jashtëm dhe të brendshëm i auditimit 2 pikë, nga raportimi i kryetarit para kuvendit komunal 1 pikë, nga pjesëmarrja e qytetareve në diskutime publike 1 pikë, nga aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuar me publikun 3 pikë, nga publikimi i raporteve për konsultime publike janë humbur 4 pikë, nga çështje të auditimit të adresuara sipas raportetve e ZKA-së janë humbur 4 pikë si dhe për shkak të mungesës se planeve rregulluese të hollësishme janë humbur 3 pikë, për herëve të tjera duhet të jemi më të kujdesshëm ku kemi marrë vlerësim negativ në mënyrë që t'i fitojmë të gjitha piket.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** unë e kam bërë edhe sqarimin për opinionin ne 100% as nuk i kemi arrit as nuk mundemi me i arrit, janë dy çështje njëra me takon mua tjetra i takon zyrës se tatimit pra janë përgjegjësi e jona, nëse nuk i kemi arrit 100% i kemi arrit pra 80%. Ne i kemi dërguar kërkesat tona në ministri janë aprovu në projektet të cilat kemi me i shfrytëzua këto mjete, të cilat janë projekte gjithëpërfshirëse për qytetaret.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi e hapi diskutimin për piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

**Filloreta Bujupi,** pyeti Drejtorin e Shëndetësisë çka është në pyetje që nuk ka shofer në QKMF në Komoran por duhet pacienti me prit derisa tekniku ta jep infuzionin për me e dërgu transportin për Prishtinë?

**Drejtori i Shëndetësisë-Arsim Haxhiu,** numri i certifikuar prej 180 punëtoreve nuk lejon, por lejon që në të ardhmen puna me trajnime puna shtesë e mjekeve infermiereve të jetë pune përbërëse e një shërbimi emergjent ku do të ketë patentë shoferin trajnime vozitjes etj. Ne tani kemi plotësuar numrin qind për qind e mjekeve dhe infermiereve me numrin e banoreve. Kjo është çështja që është paraparë edhe në ligjin e emergjencave është e paraparë edhe në udhëzimin administrativ 04/2020 në këtë drejtim jemi në kuadër të planit.

**Egzona Tërdevci,** kur do të hapet thirrja për subvencione në fushën e shëndetësisë përkatësisht për organizata që ofrojnë ndihmë për persona me nevoja të veçanta?
Lexoj një kërkesë që e ka parashtruar një qytetar i komunës, këtë kërkesë e ka parashtruar qysh nga dt. 28.02.2022 por akoma nuk ka marrë përgjigjeje. Kërkesë nga Sabri Gashani nga fshati Terstenik punëtor në Feronikel po tani jemi në pushim të detyrueshëm arsyeja e ndaljes se punës në këtë kompleks, gruaja ime Zyrafete Gashani është e sëmur dhe i duhet tri herë në jave të shkoj në Prishtinë për dializë ku këtë sëmundje e ka tash e 22 vite, si pasoj e gjendjes se renduar të saj ne që një vit ne familjaret e saj, po na duhet me dërgua me veturë në spital për dialize sepse nuk po mundet ta përballoj udhëtimin me kombibusin e organizuar nga komuna, çmimi i karburanteve është rritur shumë dhe punën në Feronikel e kemi ndërprere arsyeja vetëm dihen, kërkoj nga drejtoria për shëndetësi të gjej një formë dhe të më ndihmoj në kompensim të karburanteve apo në çfarë do forme tjetër të ndihmës, gruan e kam pothuajse të palëvizshme, nuk mund të ec pa ndihmën e diku na duhet gjithsesi dy veta ta dërgojmë në tretman prandaj nuk kemi zgjidhje tjetër vetëm se ta dërgojmë me veture private, besoj që kjo kërkesë te shqyrtohet dhe të aprovohet.

**Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu,** shërbimet e hëm dializës janë të kontraktuara dhe ajo kontratë ka një menaxher kontrate, dhe kjo nuk është hera e parë që ka bërë kërkesë, ne e kemi transportuar, transporti është në dispozicion mirëpo vazhdimisht ka kërkesa shtesë, drejtoria përmes kantatës i ka të përcaktuara, ne kemi pas raste kur edhe pacienti ka qenë në shtat por e ka marrë transportuesi çoftë edhe për një rast të vetëm, prandaj personi në fjalë duhet t'i drejtohet menaxherit dhe jo drejtorisë. Sa i përket subvencioneve ne jemi ne përfundim e sipër dhe analizë e sipër të shërbimeve ku i kemi disa shërbime në kuadër të shërbimit parësor shëndetësor por në grupacione të ndryshme dhe nëse e shohim se ka nevojë do ta shpallim ku do të përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara.

**Mehedin Salihu-** para dy dite ka ndërruar jetë një punëtor në QKMF, por për fat të keq as faqja e komunës mirëpo as këtu nuk u mbajt një minutë heshtje, kërkoj nga ju një minutë heshtje për nder të veprës dhe jetës se teknikut Hysen Krasniqi.

**Mergim Pirraku-** pyeti për Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport pse qyteti jonë nuk ka trup teatrore, dhe 80 % e qyteteve tjera pothuajse kanë trup teatrore, jemi në vitin 2022 dhe ende nuk ka as edhe një iniciativë me pas një trup teatrore kur e dina se qyteti jonë ka aktor, regjisor skenarist jo vetëm të dëshmuar vetëm në Kosovë por edhe në arenën ndërkombëtare. Pyetja tjetër jam anëtar i një klubi të shahut në Drenas, qyteti e ka pas një klub të shahut i cili është themeluar mbi 40 vjet dhe ka pasur suksese brenda Kosovës para tri viteve për shkak të

mos financimit, ai klub ka qenë afër 10 vjet duke e financuar vet aktivitete tona që i kemi pas, dhe para tri viteve ai klub është shuajt. Një klub tjetër i cili është po ashtu i shahut në Drenas quhet klubi i Drenasit për shahun fillon garat në javën e ardhshme për shkak të mjeteve nuk po mundet me pagu kuatizimin që e ka detyrim nga federata e shahut, a mundeni ju me marr si kërkesë nga ana ime që me e përkrah atë klub që mos të shuhet sepse unë konsideroj se është shumë me rendësi.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** sa i përket teatrit amator ne jemi çdo ditë të gatshëm me e bërë me ato kushte dhe mundësi që i kemi, teatër profesional e kanë të lejuara vetëm 6 komuna, ne nuk mundemi me pas teatër profesional nuk na lejohen mjete nga niveli qendror për atë qellim. Sa i përket klubit të shahut nuk është se ne nuk i kemi financu apo nuk i kemi ndihmuar.

**Mergim Pirraku-** unë e kam lexuar ligjin për themelimin e tetarëve, unë po e bëjë si kërkesë, procedura ishte e shumë e thjeshtë, vetëm duhet me e bërë një kërkesë nga drejtoria përkatëse dhe financimin krejt po e mbulojke Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, komuna nuk ngarkohet me asnjë mjet.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** ne kemi bërë kërkesa ndërsa përgjigjja ka qenë nuk lejohet për komunën tonë, është marrë një vendim për disa komuna lejohet për teatër profesional ndërsa teatër amator mundemi me e bërë kur të doni mirëpo ata dojnë me paga dhe nuk kemi asnjë mundësi për këtë çështje.

**Azemine Bujupi-Gjoka,** kam dy pyete për Drejtorinë e Arsimit Muhamet Gjoka, cila është arsyeja e mos realizimit e transportit dhe shujtës ditore për nxënësit e shkollës se mesme profesionale "Fehmi Lladrvci" për realizimin e pjesës praktike në lenden profesionale?
Pse plan programet mësimore dhe marrëveshja me pronaret e bizneseve ishin kryer me kohë nga ana e mësimdhënësve dhe stafit udhëheqës por kjo gjë nuk ndodhi ashtu siç është e planifikuar dhe ministria për këtë qellim ka dhënë subvencion me vlerë prej 77 mijë euro për realizimin e pjesës praktikë për nxënësit e shkollës profesionale ndërsa mësimdhënësit kanë kërkuar nga 4 euro nxënësve për një vazit ditore si e komentoni këtë? Na sqaroni pse nuk u realizua ai projekt dhe çfarë do të bëni me këto mjete pasi që nuk u shfrytëzuan nga për vitin 2021-2022 ashtu siç paraparë me herët.

**Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka-** sa i përket kërkesës tuaj ju njoftoj se ka qenë në procedure të prokurimit dhe për arsye të papërgjegjshmërisë të operatoreve për çështje teknike është anuluar dhe është rishpallë, ju njoftoj se kontrata është lidhë e kemi në dispozicion dhe mund të planifikohet, kjo kontratë është kontratë kornizë dhe mund ta shfrytëzojmë edhe viteve tjera. Mjetet janë të planifikuara nga kategoria mallra dhe shërbime ne varësisht nga kërkesat që vijnë dhe sigurisht se kemi me e menaxhu buxhetin e paraparë për ketë aktivitet varësisht prej shpenzimeve që behën do ta planifikojmë.

**Azemine Bujupi-Gjoka,** kjo beso se nuk mund të realizohen më për arsye kanë mbet edhe dy jave mësim dhe tani është vetëm vlerësimi i nxënësve, mirëpo a është dashur me e bërë një planifikim qysh në muajin tetor në fillim të vitit shkollor dhe kjo besoj se duhet me ndodh vitin tjetër.

**Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka-** këtë vit për çështje teknike nuk është realizuar, mirëpo pajtohem me atë se tani vetëm është lidh kontrata dhe e kemi të planifikuar tani mbetet

planifikimin e mësimdhënësve me bizneset të cilat kemi marrëveshje dmth vetëm agjenda mund të përcaktohet sepse me nuk kemi nevojë për procedura tjera.

**Mehedin Salihu-** i falënderoj ekipin e emergjencës në QKMF-në në Drenas të cilët e kanë kthy në jetë një fëmijë 11 vjeçar që e kishte zënë rryma.

**Valentina Leku,** kam disa kërkesa nga administrata e fshatit Llapushnik me primare është asfaltimi dhe rregullimi i ujerave të zeza pran shkollës, dhe çka ka ndodh në lagjen Tahiraj në fshatin Llapushnik varrezat kanë qenë pronë publike ndërsa me letra tani figuron se është pronë private kërkoj një sqarim? Një segment mes rrugës "Zeqir Bajrami" dhe "Nasip Maliqi" tek mbi kalimi me gjatësi prej 60 m është një vend që duhet të i asfaltohet dhe të behet rrethoja pasi që paraqet një rrezik për nxënësit që kalojnë në atë vend. Kërkoj që të asfaltohet rruga prej 100 m që lidh dy rrugë, rruga "Zeqir Bajrami" dhe "Beteja e Llapushnikut" Gjithashtu administrata e fshatit Llapushnik kërkojnë një bashkëpunim më të mirë dhe të jeni me bashkëpunues drejtoritë përkatëse sepse ata janë legjitim në atë vend dhe i njohin problemet e banoreve nga afër.

**Nënkryetari i Komunës Arben Shala-** sa i përket kërkesave të administratorit të fshatit janë të lirë dhe kanë has gjithmonë mirëkuptim në paraqitjen e kërkesave të tyre, ndërsa sa i përket kanalizimit të ujerave të zeza ka pas një problem ka pas pengesa gjatë punimeve dhe për atë arsye operatori është tërheq dhe besoj se kjo çështje do të zgjidhet dhe do të vazhdojmë tutje.

**Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:55 min .**

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 30.06.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

Procesmbajtëse:
______________
Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
______________
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
Pranuar 17.06 2022
Nj. Org | | | Vlera
02-060/03-28463

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17.06.2022, si vijon:**

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e KPF-ca, për rendin e ditës, dhe i njoftoi anëtaret e KPF-së se kemi edhe dy pika shtesë për rendin e ditës:

1. Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.
2. Raporti i auditimit të Komunës së Gllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31,dhjetor 2021.

|---|---|---|---|---|---|---|
| Z.Kryetarit | 159,321 | 54,900 | | 9,000 | | 223,221 |
| D.Administratës | 238,005 | 147,144 | | | 4,000 | 389,149 |
| D.Inspeksionit | 69,269 | 52,250 | | | | 121,519 |
| Z.Kuvendit | 111,029 | 23,150 | | | | 134,179 |
| D.Buxhet-Finan. | 104,930 | 18,300 | | | | 123,230 |
| D.Sh.Publike | 165,771 | 292,269 | 165,500 | 110,000 | 183,000 | 916,540 |
| D.Infrastrukturë | 50,256 | 26,800 | | | 5,910,886 | 5,987,942 |
| Z.Kom.Komun. | 8,076 | 680 | | | | 8,756 |
| D.Bujqësi,Pyllta | 77,000 | 12,400 | | 75,000 | | 164,400 |
| D.Zhv.Ekon. | 49,476 | 26,400 | | 60,000 | | 135,876 |
| D.Gj,K,Pronë | 84,993 | 10,150 | | | | 95,143 |
| D.Urbanizem | 48,520 | 14,481 | | | 40,000 | 103,001 |
| D.K,R,Sport | 76,049 | 122,175 | | 125,000 | 540,000 | 863,224 |
| Ad.Shëndetësi | 36,933 | 53,340 | | 35,000 | | 125,273 |
| Q.K.M.F-ja | 1,316,965 | 620,815 | 81,029 | | 699,781 | 2,718,590 |
| Q.P.S-ja | 92,884 | 43,713 | 9,200 | | | 145,797 |
| Adm.Arsim | 78,302 | 239,000 | | 90,000 | 405,000 | 812,302 |
| Ars.Paraf-Qer. | 121,787 | 77,482 | 6,549 | | | 205,818 |
| Ars.Fillor | 4,630,991 | 597,862 | 65,000 | | | 5,293,853 |
| Ars.Mesem | 1,310,597 | 291,008 | 22,000 | | | 1,623,605 |
| R.përmbledhës | 8,831,154 | 2,724,319 | 349,278 | 504,000 | 7,782,667 | 20,191,418 |

Tabelat e lartshenuara, paraqesin planifikimin e shpenzimeve sipas karakterit ekonomik dhe funksional për vitet 2023-2025, bazuar në kërkesat fillestare të mbajtësve të buxheteve komunale (drejtoratet dhe zyrët komunale). Vlerësimet e përgjithshme për kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve janë si më poshtë:




**3.3.1 Pagat dhe Mëditjet** - Qarkorja buxhetore 2023/01-MFPT., përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, e po ashtu Pagat dhe shtesat. Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik, përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti. Pagat dhe shtesat: Programet buxhetore duhet të planifikojnë rritjen vjetore të faturës së pagës në nivel prej 0.5% sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063.Kërkesat e programeve buxhetore për paga dhe mëditje të paraqitura në tabelat e lartë shenuara janë fillestare, të cilat në fazat e më vonshme të planifikimit të buxhetit do të vlerësohen dhe miratohën sipas Qarkores Buxhetore 2023/02-MFPT.

**3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet.**- do të mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Programet buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit qendror dhe lokal, për përmbushjen e aktiviteteve me prioritet të lartë. Mjetet e planifikuara duhet të shpërndahen në menyrë objektive nëpërnënkategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe dotë mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme.

**3.3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale**.- priten të ketë pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2022.

**3.3.4 Subvencionet dhe transferet**: kjo kategori ekonomike e shpenzimeve pritet të rritet mesatarisht për 0.5% në periudhën afatmesme. Kërkesat fillestar buxhetore të mbajtësve të buxheteve, duke u bazuar në projekte konkrete, do të financohen varësisht nga kufiri i caktuar me Q.B/02-MFPT.

**3.3.5 Investimet Kapitale** - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 34.89% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritare që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e jetës së qytetarve. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshem planifikohet të bashkëfinancohenë me ministrit e linjës dhe donatorët.

### 3.4 Analiza Gjinore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, si në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 8:*

| Kategoria | Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011 | % | Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2023 (31 dhjetor 2023) | % |
|---|---|---|---|---|
| Gra | 13,516 | 23.12 | 15,240 | 23.13 |
| Burra | 13,956 | 23.88 | 15,742 | 23.86 |
| Vajza | 15,242 | 26.01 | 17,145 | 26.07 |
| Djem | 15,737 | 26.99 | 17,792 | 26.92 |
| **Popullata e përgjithshme** | **58,451** | **100.oo** | **65,919** | **100.oo** |

Meqenëse deri më tani është punuar në projekte kapitale të infrastrukturës, ndarja buxhetore nuk ka mund të bëhët sipas barazisë gjinore. Komuna në të ardhmen do të mundohët që të bëjë planifikimin e investimeve kapitale në proporcion të barazisë gjinore. Me zvoglimin e numrit të projekteve në infrastrukturë, do të mbesin mjete për projekte tjera dhe do të merret parasysh më përseafermi barazimi gjinor gjatë shqyrtimit të projekteve të ndryshme. Komuna tani për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhëshem buxhetor ka një analizë, e cila do të shërbejë si bazë për ndarjën buxhetore sipas barazisë gjinor. Më te synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave.

## V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

### ZYRA E KRYETARIT

**Misioni:** Bënë mbikqyerjën e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, në pajtim më kryesuesin e Kuvendit konvokon mbledhjet e Kuvendit të Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, si dhe bënë propozime për qeshtje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës.
**Vizioni:**Avansimi dhe perfeksionimi i menaxhimit në pajtim më të gjitha normat ligjore.Arritja e pajtueshmerisë se plotë me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon Komuna. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore me një nikoqirllak dhe duke u bazuar në parimin vlera për parat. Avansimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha burimeve humane.
**Qëllimi:** Ngritja e zhvillimit ekonomik, ngritja e mirëqenjës sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim. Orimi sa më i mirë i të gjitha shërbimeve për qytetarët e Komunës. Shendrrimi i administratës në nji administrat moderne, sa më funksionale dhe të rregullt. Shfrytëzimi sa më racional edhe ekonomik i të gjitha burimeve njerzore,financiare dhe materjale që ka Komuna në të mirë të të gjith qytetarve.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri i të punësuarëve | 16 | 16 | 16 |
| 2 | Numri i shërbimeve | | | |
| | Konvokimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me kryesuesin | 12 | 12 | 12 |
| | Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për politikë dhe financa dhe komitetet tjera | 20 | 20 | 20 |
| | Përfaqësimi i Komunës brenda dhe Jashtë vendi Organizimi i mbledhjeve me publikun dhe perfaqsuesit e komuniteteve | 15 | 15 | 15 |
| | Kryerja e auditimeve të rregullta | 8 | 8 | 8 |
| | Raportimet para Komitetit të Auditimit | 6 | 6 | 5 |
| | Raportimet para Njësisë Qendrore Harmonizuese | 4 | 4 | 4 |
| | Bashkëpunimi me ZAP-in | 2 | 2 | 2 |
| | Bashkëpunimi më medijat e shkruera dhe elektronike | 365 | 365 | 365 |
| | Redaktimi i faqës zyrtare të informimit të Komunës | 200 | 200 | 200 |
| | Regrutimet e punonjësve të rinjë | 5 | 5 | 5 |
| | Trajnimi i punonjësve | 70 | 70 | 70 |
| | Avansimi i punonjësve | 10 | 10 | 10 |
| | Raportimi për rrjedhën e detyrave në lidhje më PVPE | 30 | 30 | 30 |
| | Përfaqësimi i Komunës në Kontestet gjyqësore | 35 | 33 | 30 |
| | **Gjithësej: kuantitativ** | **782** | **792** | **788** |

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

## ZYRA E KUVENDIT

**Misioni:**Zbatushmeria e ligjeve në fuqi, përgatitja e akteve normative në përputhshmeri me ligjin si dhe arhivimin e të gjitha këtyre akteve.
**Vizioni:**Planifikimi i punëve sipas ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore dhe realizimi i këtyre punëve sipas planifikimit.
**Qëllimi:** Përgatitja e materjalit për kuvend, mbajtja e procesverbalve dhe nxjerrja e vendimeve të aprovuara nga kuvendi si dhe dergimi i këtyre akteve për MAPL-al.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri i të punësuarëve | - | - | - |
| 2 | Numri i shërbimeve | | | |
| | Punët kuantitative në nr. Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit | 12 | 12 | 12 |
| | Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të KPF | 14 | 14 | 14 |
| | Pranimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi dhe dërgimi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend | 60 | 60 | 60 |
| | Mbajtja e procesverbalëve në mbledhjet e KPF-së dhe Kuvendit | 26 | 26 | 26 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Përgatitja e vendimeve të dala nga Kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve Kryetarit të Komunë dhe MAPL | 60 | 60 | 60 |
| | Takimet e Komitetit për Komunitete dhe atyre konsultative me Komisionet e Kuvendit Komunal | 44 | 44 | 44 |
| | **Gjithësej:** | **216** | **216** | **216** |

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

## DREJTORATI PËR ADMINISTRAT TË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ushtron dhe zbaton shërbime të përgjithshme për organet administrative dhe tjera komunale, si dhe ofron shërbime për qytetarët e Komunës së Drenasit në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

**Misioni:** Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët në afat të shkurtër kohor dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të Bordit të Drejtorëve dhe trupave tjerë punues. Të Siguroj shërbime efektive për qytetarët dhe të siguroj transparencën e shërbimit civil komunal.

**Vizioni:** Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe cilësore për qytetarët, organet administrative dhe organet e tjera komunale. Vizjoni dhe qëllimi ynë si drejtorat është të ofrojmë shërbime më të mira komunale, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmes tyre të rrisim shkallën e knaqëshmerisë së qytetarëve për shërbimet administrative komunale.

**Qëllimi:** Qëllimet e Drejtorisë së Administratës janë ngritja e performancës komunale, shërbime komunale cilësore për qytetarët dhe organet e saj administrative.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **42** | **42** | **42** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Ekstrakte certifikatash të gjendjës civile | 55000 | 56000 | 57000 |
| | Procedura të prokurimit publik | 200 | 225 | 230 |
| | Vërtetime të ndryshme dhe legalizim dokumentësh | 298 | 305 | 310 |
| | **Gjithësej:** | **55498** | **56530** | **57540** |

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2023-2025 do të kryhën me cilësi, nëse lejohët buxheti i kërkuar më lartë, në të kunderten do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

## DREJTORATI PËR INSPEKSION

**Misioni:** Menaxhimi dhe mbikqyrja e zbatimit të detyrave programore të inspektorve në kuader të drejtoratit, hartimi i planeve ditore dhe javore në zbatimin e programeve të punës në të gjitha lëmit inspektuese.

**Vizioni:**Sigurimi i të gjitha procedurave, udhzimeve dhe politikave për inspektimin sa më të mirë të aktiviteteve të këti Drejtorati.

**Qëllimi:**Qëllimi kryesor i Drejtoratit të Inspeksionit është mbikqyrja e ndertimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje ndertimi dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje ndertimi,inspektimi lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve ekonomike me certifikata të biznesit, si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. Po ashtu qellimi i këtij drejtorati është mbikqyerja e kualitetit të ushqimit të produkteve të amballazhuara dhe të pa amballazhuara, ujit të pijës pastertisë

se qytetit, tregjeve, rrugëve, trotuarve si dhe inspektimi i ujrave të zeza etj.Qellim tjeter është mbikqyerja e kompanive transportuese në komunikacionin rrugorë,orari i udhëtimit, inspektimet në leminë e bujqësisë farërat, plehrat, të mbjellat pranverore e vjeshtore etj.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **10** | **10** | **10** |
| 2 | **Numri i shërbimeve: Kuantitative** | | | |
| | kontrollime | 2030 | 2150 | 2250 |
| | Procesvebale | 1250 | 1380 | 1830 |
| | Pëlqime | 130 | 150 | 200 |
| | **Gjithësej kuantitative:** | **3410** | **3680** | **4280** |
| 3 | **Numri i sherbimeve: Kualitative** | | | |
| | Aktvendime | 280 | 300 | 300 |
| | Fletparaqitja | 120 | 150 | 180 |
| | Konkluzione | 80 | 100 | 100 |
| | Konfiskim malli | 20 | 25 | 30 |
| | **Gjithësej kualitative:** | **500** | **575** | **610** |

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2023-2025 do të kryhën me cilësi nëse lejohët buxheti i kërkuar më lartë, në të kunderten do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

## DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

**Misioni:** Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konformë me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të obligimit dhe detyrave që i ka për të i kryer.
**Vizioni;** Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konformë me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të implementimit dhe realizimin e politikave fiskale të hartuar nga Qeveria qendrore dhe implementimin e politikave lokale.
**Qëllimi:** Drejtorati për Buxhet dhe Financa bënë planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit – financave të komunës i siguron programet- nënprogramet (drejtoratet dhe zyret komunale) me shërbimet e kontabilitetit, duke siguruar raportim ditor, javor , mujor , periodik dhe përfundimtar lidhur më zhvillimin e buxhetit komunal si dhe informon lidershipin komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin- financat e komunës.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **16** | **16** | **16** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Zhvillimi i aktiviteteve për planifikimin e buxhetit 2021-2023, sipas kërkesave fillestare, | 1 | 1 | 1 |
| | Përgatitja e Kornizës afatmesme Buxhetore 2021-2023 | 1 | 1 | 1 |
| | Vertetime per pasuri për qytetar lidhur me rregullimin e dokumentacionit | 19,956 | 20,030 | 20,050 |
| | Aprovimi i pagesave | 4,119 | 4,125 | 4,130 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Zotime për ekzekutim pagesave | 4,119 | 4,125 | 4,130 |
| | Shpenzime | 4,119 | 4,125 | 4,130 |
| | Lëshimi i faturave sipas kërkesave të palve | 10,240 | 10,300 | 10,350 |
| | Objekte të reja të matura dhe rimatura | 724 | 730 | 750 |
| | Numri i ankesave dhe kërkesave për korigjim | 60 | 65 | 70 |
| | Kërkesa për regjistrimin e objekteve të reja | 203 | 210 | 230 |
| | Anketim i tatimpaguesve | 2,550 | 2,650 | 2,700 |
| | Modifikim i të dhënave të pronës | 27,350 | 27,400 | 27,450 |
| | Modifikim i të dhënave të tatimpaguesve | 11,119 | 11,125 | 11,130 |
| | Verejtjet e fundit | 212 | 220 | 230 |
| | Raporte të barazimit tre mujor | 4 | 4 | 4 |
| | Raporte financiare tre mujore | 4 | 4 | 4 |
| | Raporte pune gjashtmujore | 2 | 2 | 2 |
| | Raporti vjetor dhe Pasqyrat vjetore financiare | 1 | 1 | 1 |
| | Pagesa arke peti cash | 35,176 | 35,200 | 35,250 |
| | **Gjithësej:** | **119,962** | **120,318** | **120,613** |

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë me afat, performancë të lartë dhe të bazuara në ligje dhe dispozita ligjore në fuqi, duhet të sigurohën mjete financiare sipas kërkesave për kategori ekonomike të shpenzimeve.

## ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

**Misioni:**Raporton rregullisht Kryetarin e Komunës për punën e Zyrës, i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës raport vjetor, paraqetë raport në çdo takim të Komitetit për Komunitete , informon dhe raporton tek institucionet e Qeverisë Qendrore lidhur me aktivitetet e Zyrës, i propozon Kryetarit të Komunës një buxhet vjetor për të siguruar një funksionim të duhur të Zyrës dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kompetencave të veta, merr pjë në mbledhjet e Drejtorve të Komunës, bashkëpunon ngushtë me institucionet e Qeverisë qendrore dhe me organizatat e tjera vendore e ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të Komuniteteve, Kthim dhe Riintegrim.
**Vizioni:**Të kontribuon drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta.
**Qëllimi:**Të këshilloj autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **1** | **1** | **1** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Vizita tek personat e riatdhesuar | 350 | 380 | 400 |
| | Vizita tek komunitetet pakicë | 30 | 36 | 40 |
| | Shqyrtimi i kërkesave të tyre | 190 | 180 | 190 |
| | Mbledhjet me Komitetin për Komunitete | 10 | 10 | 10 |
| | Mbledhjet me Komisjonin Komunal për Riintegrim | 12 | 12 | 12 |
| | Takimet me Institucionet e Qeverisë së Kosovës | 30 | 28 | 32 |
| | Takimet me organizata lokale dhe nderkombëtare | 20 | 15 | 18 |
| | **Gjithësej:** | **641** | **661** | **702** |

Për realizimin e shërbimeve të planifikuara më lartë kërkohet miratimi i buxhetit të planifikuar me kërkesa buxhetore.

## DREJTORATI PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

**Misioni:**DBPZHR, është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës, duka përfshirë: Përgatit dhe zbaton politika të cilat nxisin zhvillimin e Komunës, mundësojnë zhvillimin e bizneseve bujqësore intensive,zhvillimin e bujqësisë përmes përmirësimit të kushteve infrastrukturore, ngritjen e kapaciteteve të fermerëve për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe mbështetjen sektorjale në krijimin e ambienteve të volitshme, përkrahjen e investitorëve vendor dhe të jashtem për një synim të qëndrushëm të bujqësisë dhe punësimit.
**Vizioni:**DBPZHR- është përcaktuar ta forcoj sektorinë e bujqësisë në të gjitha lëmitë e agrobizneseve, të bëjë të mundshëm programet e qëndrushme bujqësore. Krijimi i një sistemi sektorjal bujqësor intenziv dhe të qëndrushëm ekonomik.
**Qëllimi:** DBPZHR-ka për qëllim ta krijoj një sistem sektorjal të bujqësisë intenzive në rritjen e prodhimtarisë dhe të cilësisë për një konkurrencë të denjë në tregun Vendor dhe Rajonal, si dhe mbështetjën e agrobizneseve, fermerëve të vogël, të mesëm dhe të mëdhenjë, përmesë granteve dhe subvencioneve, sektorjalizimin dhe zbatimin e kritereve në dhënien e subvencioneve për fermerët, përkrahjen e zhvillimit të agrobizneseve duke synuar nxitjen e ndërtimit të identitetit dhe brendeve.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **13** | **13** | **13** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Kërkesat e ndryshme për përkrahje në bujqësi | 370 | 410 | 450 |
| | Mbështetja e infrastrukturës në projektin e sistemit të ujitjes | 200 | 210 | 230 |
| | Subvencionimi në Sektorin e Blegtorisë | 180 | 220 | 250 |
| | Subvencione në Sektorin e Lavertarisë | 550 | 590 | 610 |
| | Subvencione në Sektorin e Pemëtarisë | 180 | 200 | 230 |
| | Subvencione në Sektorin e Perimtarisë (Prodhimtarisë Bimore) | 140 | 160 | 180 |
| | Lëndet për subvencionimin në Grurë, Misër, Perime, Pemë etj. | 800 | 820 | 850 |
| | Ngritja e kapaciteteve trajnuse në bujqësi | 530 | 580 | 640 |
| | Krijimi dhe fuqizimi i shoqatave në Sektorin e Biznesit në Buj. | 3 | 5 | 7 |
| | Mbeshtetja e Sektorit të BMA-së | 30 | 40 | 45 |
| | Mbrojtja e Pyjeve, dhe numëri i fletëparaqitjeve | 40 | 35 | 30 |
| | Trajtimi i Pyjeve me veprime silvikulturore teknike-rrallime | 20 | 30 | 35 |
| | Pyllzimet në sektorin publiko privat | 15 | 20 | 25 |
| | Krasitja e halorëve të reja të pyllëzuara pas lufte | 10 | 15 | 20 |
| | **Gjithësej:** | **3068** | **3335** | **3602** |

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me suksesë, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

## DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

**Misioni:** Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është bartëse e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Hartave Zonale dhe Planeve Rrgullative Urbane të Hollësishme, bënë implementimin e tyre dhe lëshon lejet e ndërtimit, kujdeset për dokumentacionin investivo-teknik dhe

përputhshmërinë e tij me kushtet e dhëna ubano-teknike, lejon shfrytëzimin e hapsirave publike, mbulon sferën e banimit, bashkëpunimin e ngushtë me nivelin qendror përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA).
**Vizioni:** Komunë me zhvillim të balancuar, planifikim të qëndrueshëm urban, banim mcilësor, mjedis të pastër..
**Qëllimi:** Në sektorin e planifikimit qëllimi kryesor është angazhimi në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorvr dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrushëm të qytetit dhe trajtimin e kërkesave brenda afatit ligjor, dhënia e kushteve të ndërtimit dhe leje të ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane. Ndërsa në Sektorin për Mbrojtje të Mjedisit është monitorimi në zhvillimin dhe zbatimin e dokumentacionit në fushën e mbrojtjes së mjedisit në trajtimin e menaxhimin e mbeturinave, ruajtjen e cilësisë së ajrit, mbrojtja nga zhurma, mbrojtja e natyrës të cilat kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **8** | **8** | **8** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Kushtet Ndërtimore | **20** | **25** | **30** |
| | Leje të ndërtimit | **20** | **25** | **30** |
| | Leje Rënimi | **15** | **20** | **25** |
| | Certifikata e Përdorimit | **10** | **15** | **25** |
| | Pëlqimet Urbanistike | **450** | **550** | **650** |
| | Dhënja në shfrytëzim të përkohshëm të hapsirës publike | **150** | **200** | **250** |
| | Hartimi dhe Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028 | **1** | **0** | **0** |
| | Hartimi dhe Miratimi i Hartës Zonale të Komunës 2020-2028 | **1** | **0** | **0** |
| | | | | |
| | **Gjithësej:** | **677** | **850** | **1030** |

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me suksesë, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve

## DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS

**Misioni:** Misjoni i kësaj Drejtorie është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që jane te parapara me Statutin e Komunës për Drejtorin e SHP&E-së, duke përfshirë këtu : Mirëmbajtja e Shërbimeve Publike, Projektet kapitale, Shërbimin e Zjarrfikësve, Subvencionimi dhe reagimi ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
**Vizioni:** Vizjoni i DSHPE-së është ç'doherë e gatshme në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duke ofruar shërbime cilësore në shkallën e kënaqshmerisë.
**Qëllimi:** Është që të realizoj të gjitha kërkesat ndaj shërbimeve për qytetarë duke përfshirë mirëmbajtjen e projekteve , Projektet Kapitale, Subvencionet, në menyrë që ta ngrisë cilësinë dhe standardin e qytetarve për shërbime publike duke përfshirë:Mirëmbajtja edhe Pastrimin e rrugëve verë-dimër, Mirëmbajtjene rrugëve të asfaltuara, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV-të, rregullimin e Trotuarëve dhe parkingjeve , Eliminimin dhe Pastrimi I deponive ilegale, Menaxhimin e mbeturinave, Mirëmbajtja dhe rregullimi I pikave grumbulluese për kontenjer, Mirëmbajtjen e kanalizimeve fekale dhe atmosferike, Mirëmbajtjen e Ndriqimit Publik, Mirëmbajtja e Parqeve, Sheshit dhe hapsirave të gjelbruara, Rastet e Fatkeqësive Natyrore, Mirëmbajtja e tregjeve, Mirëmbajtja e varrezave, Shenjizimi

vertikal dhe horizontal I rrugëve, Menaxhimi I stacionit të autobuesëve, Menaxhimi I taxi-ve, Trajtimi I qenëve endacak, etj.
Të gjithë këta indikatorë na shtynë që të kryejmë shërbime sa ma cilësore ndaj banorëve të Komunës së Drenasit, duke angazhuar tërë potencialin njerzorë dhe atë financiarë.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **24** | **24** | **24** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Shërbime Publike (Ujë, Kanalizim,gropa septike) | **127** | **150** | **200** |
| | Fatkeqësi natyrore dhe tjera | **75** | **100** | **130** |
| | Transport Publik | **31** | **40** | **50** |
| | Ndriqim Publik | **20km** | **25km** | **40km** |
| | Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara dhe rendit të –IV- | **513km** | **513km** | **513km** |
| | Mirëmbajtja e parqeve dhe sheshit | **3ha** | **3ha** | **3ha** |
| | Larja e rrugëve gjatë verës | **39000m²** | **42000m²** | **50000m²** |
| | Pastrimi i rrugëve nga bora | **583km** | **583km** | **583km** |
| | Shenjizimi Horizontal e Vertikal | **250** | **300** | **250** |
| | Trajtimi i qenëve endacak | **15** | **30** | **80** |
| | Menaxhimi i mbeturinave | **11** | **20** | **50** |
| | Shërbime të ndryshme | 31 | 40 | 50 |

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me suksesë, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

## DREJTORATI PËR KADASTER, GJEODEZI DHE PRONË

**Misioni**: Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, është që të siguroi menaxhimin e përgjithshëm të drejtë dhe transparent të mirëmbajtjes së pronës së paluajtshme publike dhe private në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit, konform ligjeve në fuqi.

**Vizioni:** Vizioni i këtij drejtorati është që të jetë sa më transparent në trajtimin, regjistrimin dhe mbrojtjën e pronës komunale. Si dhe ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodezike dhe të pronësisë për qytetarët e Komunës së Drenasit, në menyrë sa më efikase, të shpejt dhe transparente.

**Qëllimi:** DKGJP ka për qëllim ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodete dhe të pronësisë për qytetarët e Komunës së Drenasit, në menyrë sa më efikase, të shpejt dhe transparente, në realizimin e kërkesave për ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e pronave, kërkesave për paisje me kopje të planeve dhe fletë-poseduese e shërbimeve të tjera.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **12** | **12** | **12** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Fletë poseduese | **2752** | **2811** | **2870** |
| | Kopje plani | **722** | **750** | **787** |
| | Aktvendime mbi regjistrimin e pronës | **470** | **540** | **610** |
| | Aktvendime mbi hipoteken | **36** | **37** | **41** |
| | Vendime për shpronësime | **3** | **4** | **5** |
| | Certifikata mbi gjendjen ekonomike | **1497** | **1521** | **1562** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Aktvendime mbi marrjen e pronës së uzurpuar | **51** | **90** | **120** |
| | Konstatimi i gjendjës faktike në teren | **40** | **54** | **67** |
| | Kërkesa zyrtare për teren | **124** | **135** | **144** |
| | Kërkesa për kordinata | **110** | **134** | **145** |
| | Kërkesa për bashkim të parcelave | **78** | **87** | **95** |
| | Kërkesa për ndarje të parcelave | **470** | **540** | **670** |
| | **Gjithësej:** | **6317** | **6703** | **7119** |

## DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

**Misioni:** DKR organizon,menaxhon dhe kordinon veprimtaritë kulturore, aktivitetet sportive dhe rinore. Kordinon punën e këtyre aktiviteteve me komunat tjera, asociaciacionet, shoqatat dhe organizatat që merren më këte veprimtari. Kujdeset për trashëgimin kulturore dhe për gjith infrastrukturën ku zhvillohën aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive si dhe bibliotekat.

Vizioni: Planifikon, harton dhe mbikqyrë realizimin e plan-programit vjetor të punës së sektorve menaxhon stafin,objektet dhe buxhetin e DKRS.

**Qëllimi:** Arritja e rezultateve sa më të mira në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, begatimi i bibliotekave me literaturë dhe krijimi i kushteve sa më tëfavorshme për punën e Arkivit komunal historik.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | 13 | 13 | 13 |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Manifestimet kulturore(sofra poetike, festivali i fëmijëve ,Humoriada, koncert për mërgimtarët, RFBSH etj. Manifestimet tjera(17 shkurt, 14 qershor, përvjetore, Përkujtime etj. | **10** | **11** | **11** |
| | Aktivitete sportive, rinore (turnire, krose, gara, Zgjedhja e sportistit të vitit, muaji i rinisë, ligjërat, debate etj) | **11** | **11** | **12** |
| | **Gjithësej:** | **21** | **22** | **23** |

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me sukses, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

## DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

**Misioni:** Misjoni i Shëndetësisë është që të zhvillojë dhe të sigurojë sistem efektiv dhe efikas të mbrojtjes shëndetësore kualitative, që t'i plotëson nevojat e popullësisë pa dallim nga origjina etnike, religjioni, mosha dhe gjinia, në përmirësimin e statusit të përgjithshëm shëndetësor.
**Vizioni:** Sigurimi i shëndetit më të mirë për të gjithë banorët e Kosovës, përmes një sistemi shëndetësor efikas brenda burimeve të disponushme.

**Qëllimi:** Qëllimi kryesor i sektorit të Shendetësisë është të kujdeset për kujdesin parësor shëndetësor të qytetarëve të komunës dhe të kujdeset për permirësimin e shëndetit të përgjithshëm publik.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **200** | **200** | **200** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | **Sasia** | **Sasia** | **Sasia** |
| | Vizita mjeksore | 160000 | 170000 | 180000 |
| | Vizita mjeksore shtepiake | 1500 | 1500 | 1500 |
| | Vizita stomatologjike | 8000 | 10000 | 15000 |
| | Vizita konsultative-specialistike | 37000 | 40000 | 41000 |
| | Vizita gjinekologjike | 10000 | 12000 | 13000 |
| | Shërbime stomatologjike | 20000 | 25000 | 29000 |
| | Shërbime laboratorike | 40000 | 42000 | 45000 |
| | Shërbime rentgeni | 10000 | 13000 | 15000 |
| | Shërbime të ndryshme (dhënje injekcioneve etj) | 22000 | 23000 | 24000 |
| | Vaksionimi i fëmijve në teren | 30 | 30 | 30 |
| | Edukimi shëndetësor i popullatës në teren | 26 | 26 | 26 |
| | Bartja e pacientëve në QKUK | 1000 | 1000 | 1000 |
| | Bartja e pacientëve në Hemo-dializë | 38 | 38 | 38 |
| | **Gjithësej:** | **309594** | **337594** | **364594** |

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë, me afat, kualitet dhe të bazuara në ligje dhe dispozita ligjore në fuqi, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

## DREJTORATI PËR ARSIM

**Misioni:** Që të siguroi menaxhim të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike, po ashtu do të luaj rrol kyq në përcaktimin dhe implementimin e politikave edukative –arsimore dhe zhvillimore të arsimit që rrjedhin nga Programet e MASHT-it në Komunën e Drenasit. Zhvillimin e një procesi arsimor cilësor dhe efektiv që do t'i kontribuojë ngritjës së mirëqenjës së shoqërisë, duke ofruar edukim dhe arsim cilësor, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët si dhe cilësi të lartë në fushën e edukimit dhe arsimit në nivel parafillor, fillor dhe të mesëm në pajtim me standardet bashkëkohore.

**Vizioni:** Përmisimi i standardit të arsimit për të gjithë nxënësit dhe punonjësit e Arsimit, duke fillu nga institucionet parafillore e deri të Arsimi i mesëm, përmes përkrahjes me investime, zhvillim ekonomik dhe financa të qëndrushme.

**Qëllimi:** Drejtorati për Administratë të Arsim bënë planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të programit të Arsimit, e që ky program është i organizuar në katër nivele/nënprograme: 1) Administrata e Arsimit, 2)Arsimi Parafillor & Qerdhet, 3)Arsimi Fillor dhe 4)Arsimi i Mesëm. Ky drejtorat siguron programet/nënprogramet-drejtoratet e shkollave me Udhëzimet Administrative, Rregullore dhe legjislacionet e MASHT-it dhe monitoron zbatimin e këtyre dokumenteve ligjore, pastaj siguron shërbimet e kontabilitetit, duke dhënë raportim ditor, javor. Mujor, periodik dhe përfundimtar, lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal, si dhe informon drejtoret e shkollave të Komunës së Drenasit me aktualitetet e ndërlidhura me qështjet edukativo-arsimore, si dhe me buxhetin-financat e komunës, përkatësisht të shkollave.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **948** | **948** | **948** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Numri i lëndve të zotuara | **1770** | **1780** | **1790** |
| | Kontrata të hartuara | **570** | **530** | **520** |
| | Shpallja e konkurseve | **32** | **34** | **30** |
| | Shërbimet lidhur me regjistrimin e nxënësve | **1753** | **1813** | **1873** |
| | Shërbimet lidhur me nënalokimin e buxhetit | **1770** | **1780** | **1790** |
| | Shërbimet lidhur me përvojen e punës | **920** | **928** | **930** |
| | **Gjithësej:** | **6815** | **6865** | **6933** |

Për t'i kryer punët e lartshenuara me kualitet dhe sipas dispozitavc ligjore, kërkohet aprovimi i kërkesave buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

**DREJTORATI PËR ZHVILLIM EKONOMIK**

**Misioni:**DZHE përgatit dhe zbaton politika të cilat nxisin zhvillimin ekonomik të komunës, mundësojn zhvillimin e bizneseve, krijimin e një ambijenti të volitëshem për joshjen e investitorëve vendor, diaspores, investitorëve të jashtëm që synon zhvillim të qëndrushëm ekonomik dhe punësim.
**Vizioni:**DZHE është përcaktuar ta forcoj sektorin privat në tëgjitha lëmitë ekonomike, partneritet publiko-privat, krijimin e zonave të qëndrushme për investitor të mundëshem në programe të qëndrushme ekonomike.
**Qëllimi:**DZHE ka për qëllim ta krijoj një sistem sektorjal, rritjen e prodhimtarisë dhe cilësisë për një konkurencë të denjë në tregun vëndor dhe rajonal si dhe mbështetjën e bizneseve të vogla dhe të mesme, mbështetjën përmes granteve të ndërrmarrësve të ri.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | 7 | 7 | 7 |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Aktvendimi të Taksës Komunale për leje operative | **520** | **570** | **630** |
| | Regjistrimi i bizneseve të reja | **225** | **239** | **253** |
| | Ndryshimet në biznes | **150** | **210** | **320** |
| | Shuarjet e bizneseve | **35** | **40** | **40** |
| | Qertifikata të reja nga UNMIK në Rep.Kosovës | **50** | **60** | **80** |
| | Vërtetima të Taksës Komunale | **520** | **570** | **630** |
| | Hartimi i planeve për nxitjen e investitorëve të jashtem | **35** | **42** | **53** |
| | Ofrimi i trajnimeve për biznese | **54** | **62** | **75** |
| | Koordinimi i projekt.me partneritet publiko-privat | **27** | **32** | **41** |
| | Bashkëp.me insti.nderkom.për projekte të ndrysh. | **20** | **25** | **30** |
| | Komunikimi i vazhd.me diasporën i lidh.me biz. | **15** | **21** | **25** |
| | Promovimi i turizmit | **37** | **45** | **52** |
| | **Gjithësej:** | **1688** | **1916** | **2229** |

Ky drejtorat kërkon aprovimin e kërkesave buxhetore pa shkurtim me qëllim të kryrjës së shërbimeve të synuara.

## DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

**Misioni :** Misioni i këti Drejtorati është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara më Statutin e Komunës, duke përfshirë këtu: Projektet Kapitale si ndërtimi i rrugëve, ujësjellesit, kanalizimit, ndriqimit publik etj.
**Vizioni :** Vizjoni i Drejtoratit të Infrastrukturës është që ç'doherë e gatshme në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duke ofruar standarde sa më cilësore në realizimin e projekteve kapitale.
**Qëllimi :** Është që të realizoj të gjitha projektet kapitale të cilat dalin si rezultat i planifikimit të infrastrukturës komunale si dhe të ngritet cilësia dhe standardi për të gjitha punët e kryera. Ky Drejtorat do të kryej punë dhe detyra si më poshtë: Asfaltimi i rrugëve, Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për të gjitha vendbanimet në të cilat mungon, Ndërtimi i rrjetit të kolektorëve dhe kanalizimit të ujërave të zeza, Ndërtimi i kanalizimit atmosferik, Ndërtimi i Trotuareve, Ndërtimi i ndriçimit publik, Ndërtimi i Ujrave, Parqeve dhe Sheshеve, si dhe projekteve tjera infrastrukturore.

| Nr. | Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Numri i të punësuarëve** | **8** | **8** | **8** |
| 2 | **Numri i shërbimeve** | | | |
| | Mbikqyrja e projekteve kapitale | **270** | **290** | **320** |
| | Pranimi i punimeve në terren | **112** | **120** | **135** |
| | **Gjithësej:** | **382** | **410** | **455** |

Për t'i kryer me suksesë punët dhe detyrat e punës, ky program buxhetor kërkon aprovimin e buxhetit të kërkuar.

**Lista e projekteve kapitale është pjesë përbërse e kësaj Kornize, e plotësuar gjatë fazave të planifikimit dhe e aprovuar në Kuvendin e Komunës. Projektet janë të bazuara në Strategjin e Zhvillimit Ekonomik Komunal dhe të mbuluara me masë të mjaftueshme financiare, nga Granti i Përgjithshëm dhe të Hyrat Vetanake.**

**Drenas, më _________** **Kryetari i Komunës**

_________________

**Republika e Kosovës**
Republic of Kosovo
*Qeveria Government*
***Komuna/ Municipality Drenas (Gllogoc)***
***Kuvendi Komunal***
02 Nr. 052/01-25116 dt. 03.06.2022

| | |
|---|---|
| **Datë:** | **03/06/2022** |
| **Për:** | **Z. Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **Kopje:** | **Znj. Lumnije Krapi, Drejtoreshë e DSHPE-së** |
| **Nga:** | **Komisioni për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020 të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Drenas** |
| **Lënda:** | **Raport i punës së komisionit** |

I nderuar Z. Hajdari,

Komisioni i formuar me vendim nr. 12-020-4123 i dt. 26/01/2022 ka përfunduar punën, duke plotësuar-ndryshuar statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. në Drenas dhe e ka harmonizuar me projekt statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. të draftuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Pjesë e këtij raporti është Statuti i ri i plotësuar-ndryshuar sipas mandatatit të dhënë me vendimin nr. 12 020 4123, nenit 2 të këtj vendimi.

Me respekt,

Komisioni në përbërje:

Valmir Bajraktari – anëtar nga ekzekutivi ________

Gani Krasniqi – anëtar nga kuvendi ________

Mehedin Salihu – anëtar nga kuvendi ________

**Republik e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna e Gllogocit**
Opstina Glogovac
Municipality of Gllogoc

**Datë: 09/03/2022** **http://kk.rks-gov.net/gllogoc/**

# S T A T U T I

# I

# NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSAVE " SH.A. DRENAS (GLLOGOC)

DRENAS (GLLOGOC), Mars 2022



V.B.

Në pajtim me nenin 34, paragrafi 2, lidhur me nenin 128, të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018" e në mbështetje të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/07 maj 2015", Komisioni komunal i Aksionarëve i Komunës së Drenasit (Gllogocit) për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., në Drenas (Gllogoc), në mbledhjen e mbajtur, më datën __________ njëzëri miratoi këtë:

# S T A T U T
# TË
# NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. NË DRENAS (GLLOGOC)

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

1. Me këtë Statut rregullohen parimet themelore si, emërtimi, selia, veprimtaria e **Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Gllogoc)**, statusi juridik, përfaqësimi-prezantimi, strukturat dhe trupat organizative të institucionit publik, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur më ushtrimin e veprimtarisë së **Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Gllogoc)** (në tekstin e mëtejmë: "Statcioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Gllogoc)).
2. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Drenas (Gllogoc)**, ka statusin e ndërmarrjes publike lokale, e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë të udhëheq dhe t'i përcaktojë kushtet e udhëheqjes dhe shfrytëzimit të pasurisë së saj, të lidhë kontrata, të punësoj dhe të largojë punonjës nga ndërmarrja dhe të angazhohet në aktivitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj dhe akte nënligjore.

### Neni 2
### Baza ligjore dhe emërtimi

1. Në bazë të nenit 23, të Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike lokale, **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. nga Drenasi (Gllogoci), është paraparë në listën 2, ku janë caktuar ndërmarrjet publike lokale në nivel të Republikës së Kosovës.
2. Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, **"Stacioni i Autobusëve"**, veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Gllogoc).
3. Emërtimi i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2, të këtij neni është: NPL **"Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Gllogoc).**



V.B.

## Neni 3
## Selia Kryesore

1. Selia kryesore e ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), është në Rr. "Ilaz Kodra" pa nr. në Drenas (Gllogoc).
2. Shenja njohëse (emblema) e NPL-së do të dizajnohet nga Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike lokale dhe do të miratohet nga ky Bord i Drejtorëve.
3. Emërtimi i NPL-së duhet të jetë i mbishkruar në objektin kryesor të NPL-së në të cilën kryhet veprimtaria publike dhe atë në gjuhët zyrtare në përdorim në Republikën e Kosovës.
4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së NPL-së, vendosë themeluesi

## Neni 4
## Vula dhe emblema

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Gllogoc), ka vulën e vet, të rrumbullakët dhe katrore.
2. Vula e rrumbullakët është me diametër **2.5 cm** dhe ka këtë përmbajtje:

   **2.1 Rrethi i parë: Komuna Drenasit (Gllogocit);**
   **2.2 Rrethi i dytë: "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Gllogoc) dhe**
   **2.3 Në mes të vulës është emblema.**

3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë **6x2.5 cm,** me përmbajtje:

   **3.1 NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Drenas (Gllogoc);**
   **3.2 Njësia organizative, numri dhe data.**

4. Përmbajtja në vulat e **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), duhet të jetë e shkruar në gjuhët zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

## Neni 5
## Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) si shoqëri aksionare, është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe aktet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
2. Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet, për këtë duhet të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Republikën e Kosovës dhe të kërkohet që kjo të publikohet nga ana e Agjencisë në bazën e të dhënave të saj.

## Neni 6
## Fushëveprimtaria e ndërmarrjes

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) ka hapësirë për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, garderobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe



V B.

operatorëve të transportit, si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorëve stansportues.
**2.** Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** në Drenas (Gllogoc) është e obliguar që të mbajë evidencën për hyrjen dhe daljen e autobusëve të sektorit publik dhe të sektorit privat.
**3.** Me fuqizimin e rendit të udhëtimit, Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) është e obliguar të bëjë sistematizimin e rendit të udhëtimeve sipas relacioneve dhe kohën e nisjes së autobusëve nga stacioni.
**4.** Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) në kushte të barabarta, i'u ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues, të cilët e kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar në Komunën e Drenasit (Gllogocit), sipas tarifës së përcaktuar nga Komuna e Drenasit (Gllogocit), bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.
**5.** Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
**6.** Ndërmarrja do të kryej çdo veprim, me qëllim të marrjes së lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë së saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.
**7.** Harton dhe përpilon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrjetin e linjave urbane dhe të ia prezanton Komunës për miratim.

**Neni 7**
**Themeluesi i NPL**

**1.** Komuna e Drenasit (Gllogocit) është pronare e ndërmarrjes, me aksione 100% në pronësinë e saj.
**2.** Ndërmarrja publike lokale "**Stacioni i Autobusëve**" SH.A. në Drenas (Gllogoc) është trashëgimtare e ndërmarrjes shoqërore **N.P.T.SH. "KosovaTrans" në Drenas (Gllogoc)** dhe themelohet duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.19/2015 dhe dispozitat e Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L -009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 07 maj 2015".
**3.** Ndërmarrja publike lokale "**Stacioni i Autobusëve**" SH.A. në Drenas (Gllogoc), themelohet pas regjistrimit të Statutit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovë, sipas dispozitave të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018".

**Neni 8**
**Statuti dhe rregulloret**

**1.** Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), miraton Statutin si aktin më të lartë themelor të saj. Statuti miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Komisioni komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Gllogoc) dhe dorëzohet në organin për regjistrim të shoqërive tregtare pranë Agjencionit për regjistrimin e biznesit të Kosovës (ARBK).



V.B

**2.** Komisioni komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"**, SH.A. në Drenas (Gllogoc), në pajtim me këtë statut, dispozitat e ligjeve në fuqi e miraton, e ndryshon dhe e plotëson Kodin e etikës për ndërmarrjen puplike lokale.
**3.** Rregulloret dhe aktet tjera të Ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në në Drenas (Gllogoc), hartohen-perpilohen, miratohen, ndryshohen dhe plotësohen nga Bordi i drejtorëve i Ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në në Drenas (Gllogoc), në pajtim me dispozita të nenit 130, të Ligjit Nr-06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe të nenit 20, të Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike dhe nenit 34, të Ligjit në fjalë.

**Neni 9**
**Përgjegjësitë**

**1.** Komisioni komunal i Aksionarëve, Bordi i drejtorëve dhe stafi i Ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), është përgjegjëse për pasurinë që gëzon ajo, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i këtij themelimi.
**2.** Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është kontraktues në këtë shoqëri.

**Neni 10**
**Përgjegjësitë e themeluesve për veprimet para regjistrimit**

Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish-ndërmarrjes para regjistrimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve të tjera, pasi Shoqëria të jetë regjistruar, ajo merr përsipër përgjegjësinë për këto detyrime dhe në raste të tilla, Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), është e vetmja palë përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

**Neni 11**
**Kapitali**

**1.** Kapitali themeltar i ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) si shoqëri është **10,000.00€** (dhjetë mijë euro) dhe është i ndarë në **10,000** (dhjetë mijë) aksione ku secili prej tyre ka vlerë nominale **një (1) €**.
**2.** Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018", ku përfshihen, shuma fillestare, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve etj.
**3.** Aksionar i vetëm i ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) prej **100%** është Komuna e Drenasit (Gllogocit).



V.B

**Neni 12**
**Aksionet**

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), do të ketë listën e aksionërve.
2. Aksionet janë të formës nominale, të thjeshta ose të privilegjuara, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë dhe të transferueshme lirisht, sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi në Republikën e Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.
3. Vlera nominale e aksionit të thjeshtë të shoqërisë është: **një (1) €.**
4. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit, në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
5. Aksionet e shoqërisë zotërohen në masën **100%** nga Komuna e Drenasit (Gllogocit).

**Neni 13**
**Regjistri i aksionarëve**

1. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), themelon dhe mirëmban regjistrin e aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin. Regjistrat e tillë duhet të përmbajnë informatat e kërkuara në bazë të ligjit, si dhe çfarëdo informate tjetër që ndërmarrja e sheh si të nevojshme.
2. Ndërmarrja publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), nuk do t'i ngarkojë me taksë për shërbime të çfarëdo transferi apo dokumenti tjetër në lidhshmëri me/apo, i cili dëmton titullin e ndonjë aksioni.
3. Sekretari i përgjithshëm, mund të regjistrojë transferin e ndonjë aksioni vetëm kur t'i ofrohet dëshmia mbi transferin në pajtueshmëri me Ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
4. Sekretari i përgjithshëm duhet të lejon aksionarët, të tjerët që parashihen me ligj, si dhe agjentët e tyre relevantë të autorizuar, të shikojnë regjistrin e aksoinarëve, dhe duhet të i'u ofrojë atyre ekstrakte (fragmente) relevante nga regjistri, sipas kërkesës së tyre.

**Neni 14**
**Komisioni i Aksionarëve**

1. Komisioni i aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc), është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes publike lokale.
2. Vendimet e mbledhjes së aksionarëve janë detyruese për ndërmarrje, Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes, si dhe zyrtarët e ndërmarrjes.
3. Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kuorumi për mbledhje udhëheqësi i mbledhjes, votat e aksionarëve dhe kompetencat e mbledhjes do të rregullohen me akte të veçantë, në pajtim me dispozitat e nenit 130, të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018".

**Neni 15**
**Shpërndarja e dividendit**

1. Bordi i drejtorëve të ndërmarrjes përcakton dividendin.
2. Shpërndarja e saj do të bëhet vetëm me autorizim të aksionarit, në pajtim me nenin 88 lidhur me nenin 150 të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018".



V.B.

**Neni 16**
**Funksioni i Bordit të drejtorëve**

Kompetencat dhe përgjegjësitë e ndërmarrjes publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) do të ushtrohen nga Bordi i drejtorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, statutin e **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) dhe nga aktet të cilat vetë i ka miratuar.

**Neni 17**
**Anëtarët e Bordit të drejtorëve**

**1.** Bordi i drejtorëve përbëhet nga 5 (pesë) drejtorë me të drejtë vote.
**2.** Mandati i anëtarit të Bordit të drejtorëve, është 3 (tre) vjet, dhe mund të ri-zgjedhet edhe për një mandat tjetër.
**3.** Bordi i Drejtorëve mund ta zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe Bordi i Drejtorëve mund të shkarkojë dhe zëvendësojë kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash.
**4.** Kryesuesi kryeson të gjitha mbledhjet e Bordit dhe kuvendet e askionarëve dhe është përgjegjës për mbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e Bordit. Nëse kryesuesi nuk është i zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose kuvendet e aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash të drejtorëve të pranishëm shërben si kryesues i mbledhjes ose kuvendit në fjalë.
**5.** Anëtarët e Bordit të Drejtorëve do të shërbejnë sipas preferencës së aksionarëve dhe mund të hiqen-largohen në çfarëdo kohe me arsye apo pa arsye nga mledhja e përgjithshme e aksionarëve.
**6.** Përbërja e Bordit të drjtorëve të NPL **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) duhet të jetë në harmoni me Ligjin për barazi gjinore.
**7.** Bordi fillestar i drejtorëve, i zgjedhur nga Komisioni komunal i Aksionarëve, në bazë të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/24 maj 2018", Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L-009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/07 maj 2015" është në këtë përbërje:

1. **Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal -_-_-_-_-_-_-_-_, kryesues i Bordit;**
2. **Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal -_-_-_-_-_-_-_-_, drejtor i Bordit;**
3. **Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal -_-_-_-_-_-_-_-_, drejtor i Bordit;**
4. **Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal -_-_-_-_-_-_-_-_, drejtor i Bordit dhe**
5. **Emri Mbiemri nga V.banimi, me nr. Personal -_-_-_-_-_-_-_-_, kryeshef ekzekutiv, anëtar i Bordit;**

**Neni 18**
**Bordi i drejtorëve ka këto detyra dhe përgjegjësi si organ kolektiv**

**1.** Të respektojë ligjet, statutin e ndërmarrjes, aktet të tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin;
**2.** Të përcaktojë, dhe së paku çdo 3 (tre) muaj të rishikojë strategjinë e ndërmarrjes;
**3.** Të përgatisë dhe të miratojë strategjinë afatmesëm apo afatgjatë, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe brenda afatit relevant kohor, të rishikojë atë kurdo që është e nevojshme, së paku në çdo 3 (tre) muaj të bëj ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme;



V.B.

**4.** Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv, në bazë të planit afatmesëm apo afatgjatë;
**5.** Të emërojë, largojë apo zëvendësojë Kryeshefin Ekzekutiv, të përcaktojë, me propozim të Komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe të sigurojë që procesi për përzgjedhjen e KE-së do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë shoqërisë disponueshmërinë e talentëve dhe kompetencave adekuate;
**6.** Të përcaktojë rastet, përkatësisht çështjet dhe transaksionet, të cilat nuk janë në kompetencë të KE-së, përkatësisht ka fuqi të kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuptim të dispozitave të nenit 177, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
**7.** Të emërojë dhe largojë ZKFTH dhe sekretarin e përgjithshëm, dhe në bazë të propozimit të Komisionit të auditimit, të përcaktojë kompensimin e tyre;
**8.** Të përcaktojë, me propozim të KE-së, transaksionet financiare, në bazë të të cilave KE-ja nuk do të ketë fuqinë të veprojë (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, dhe do të duhej të kërkojë autorizim paraprak nga KE-ja, apo nga Bordi i drejtorëve;
**9.** Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të ndërmarrjes mbi punën e KE-së, ZKFTH-së dhe sekretarit të përgjithshëm, mbi organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe mbi performancën e ndërmarrjes, dhe të sigurojë se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuara për të lejuar performancën dhe mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit);
**10.** Të miratojë, në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit financiarë të ndërmarrjes;
**11.** Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj;
**12.** Raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhej të përfshijë vështrimet, në atë mënyrë që performanca e ndërmarrjes të mund të barazohej me planet afatmesme apo afatgjata dhe të paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mbulimin e humbjeve;
**13.** Deklaratën për aksionarët që, sipas njohurive më të mira të Bordit të drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdesshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga Auditori i jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para datës së mbledhjes së Komisionit Komunal të Aksionarëve;
**14.** Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat janë në vendin e duhur;
**15.** Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat financiarë, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe propozim raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet;
**16.** Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga Auditori i jashtëm;
**17.** Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet në zbatim gjatë kryerjes së detyrave;
**18.** Të identifikojë, me kërkesë të KE-së, shenjat adekuate, në mënyrë që të matet rregullisht performanca e ndërmarrjes publike lokale;
**19.** Të sigurojë se veprimtaria e ndërmarrjes nuk devijon nga qëllimi që parashihet sipas Statutit pa autorizimin e qartë të Komisionit Komunal të Aksionarëve;



V.B.

20. Bordi i drejtorëve mund të udhëzojë KE-në në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendimmarrës së bashku me zyrtarët e ndërmarrjes, dhe me propozim të KE-së mund, të caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KE-së, ZKFTH-së, sekretarit të përgjithshëm dhe zyrtarit për auditim të brendshëm), duke vendosur detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

## Neni 19
## Mbledhjet

1. Bordi i drejtorëve duhet të mblidhet në vendin e caktuar sipas njoftimit me shkrim për mbledhje, në zyrën e regjistruar të ndërmarrjes apo diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e kryesuesit apo nga dy (2) e më shumë drejtorë;
2. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tre ditë para mbledhjes, në mënyrë elektronike apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë;
3. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me shkrim dhe të dërgohet me dorë, me faks apo email së paku një ditë para mbledhjes;
4. Në mbledhje, kryesuesi i Bordit të drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, duhet të përcaktojë prezencën e kuorumit, të drejtoj debatin, të mbajë procesverbalin, dhe të përcaktojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
5. Sekretari i përgjithshëm do t'i asiston kryesuesit, përveç nëse çështja e konfidencialitetit kërkon që drejtori të veproj si sekretar i mbledhjes;
6. Mbledhjet e Bordit të drejtorëve janë të rregullta dhe valide, me prezencën e shumicës së drejtorëve dhe votimin e shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje;
7. Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë paraqitur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërim. Në rast barazimi me vota, kryesuesi i Bordit të drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare;
8. Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë të pranishëm, të udhëheq mbledhjen, dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
9. Sekretari i përgjithshëm i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të perceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes;
10. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumente që ndërlidhen aty (nëse ka);
11. Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kaluar në mbledhjen e Bordit të drejtorëve, që është thirrur dhe mbajtur.
12. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtorë.

## Neni 20
## Komisioni i auditimit

Komisioni i auditimit formohet dhe ka përgjegjësi dhe të drejta, siç janë të përcaktuara në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.



V.B.

Komisioni i auditimit do të verifikoj se biznesi dhe punët e ndërmarrjes kryhen në mënyrë të ligjshme, me përgjegjësi dhe në interesin ekskluziv të aksionarëve, ashtu siç parashihet me këtë statut dhe me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

## Neni 21
## Zyrtarët

1. Zyrtarët e lartë në ndërmarrjen publike lokale **"Stacioni i Autobusëve"** SH.A. në Drenas (Gllogoc) janë: kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit, zyrtari i auditimit të brendshëm, sekretari i përgjithshëm/korporativ dhe zyrtarë të tjerë të caktuar nga Bordi i drejtorëve, në pajtim me Statutin e ndërmarrjes dhe aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.
2. Pranueshmëria e zyrtarëve bëhet në pajtim me aktet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni të bazuar në dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjin e punës në fuqi.

## Neni 22
## Përgjegjësit e Kryeshefi Ekzekutiv

1. Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes (KE) ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me ligjin, statutin dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 177, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
2. Organizimi i ndërmarrjes bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të drejtorëve;
3. Të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit komunal të Aksionarëve, Bordit të drejtorëve, Komisionit të auditimit/zyrtarit të auditimit të brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë të KE-së;
4. Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet të punësoj apo të largoj nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes duke i respektuar aktet normative që dalin nga Ligji i punës;
5. Këshillon dhe merr pjesë në Bordin e drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
6. T'i propozon Bordit të drejtorëve kandidatë të përshtatshëm për emërim si ZKFTH dhe sekretar i përgjithshëm;
7. T'i dorëzon, Bordit të drejtorëve sipas përgjegjësive të tij projekte të dokumenteve që parashikohen sipas nenit 3, pika 4, (i) dhe nenit 3 pika 4 (ii);
8. T'i ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
9. T'i dorëzon, nën përgjegjësin e tij/saj, Bordit të drejtorëve dokumente, letra dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
10. Bëjë matjen e performancës së ndërmarrjes dhe i ofron Bordit të drejtorëve rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes ndaj klientëve të saj;
11. Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe alokimin e fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjes, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në ndërmarrje;
12. Ofron Komisionit të auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
13. Ofron zyrtarit të auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohen nga ai/ajo;
14. Kryen detyra dhe punë të tjera të caktuara me ligjet në fuqi.



V.B.

**Neni 23**
**Përgjegjësit e Zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit**

1. **Zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit ("ZKFTH")** do të menaxhojë, në drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-së, çështjet financiare të ndërmarrjes. Varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për ndërmarrje dhe do të jetë përgjegjës që:

**1.1.** të mirëmbajë llogaritë e ndërmarrjes (kompanisë) të azhuruara (përditësuara) dhe të sakta;
**1.2.** të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
**1.3.** të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
**1.4.** të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e ndërmarrjes dhe buxhetin para pagesës së tyre;
**1.5.** të përgatisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim në fund të vitit;
**1.6.** të rishikojë, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;
**1.7.** të koordinojë funksionet tjera të veprimtarisë, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve;
**1.8.** të menaxhojë thesarin e ndërmarrjes;
**1.9.** të vendosë dhe përgatitë buxhetet dhe
**1.10.** të kryejë edhe punë dhe detyra tjera të caktuara nga KE.

2. Nën mbikëqyrjen e Komisionit të auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, **zyrtari i auditimit të brendshëm të ndërmarrjes,** do të jetë përgjegjës për:

**2.1.** Udhëheqjen dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së auditimit;
**2.2.** Udhëheqjen dhe drejtimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe
**2.3.** Përmbushjen çfarëdo detyre tjetër, të përcaktuar nga ana e Komisionit të auditimit.

**Neni 24**
**Sekretari i përgjithshëm i ndërmarrjes**

Sekretari i përgjithshëm i ndërmarrjes do të jetë përgjegjës për:

**1.** mirëmbajë regjistrin e askionarëve;
**2.** veprojë si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
**3.** kryejë të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj ose nga ky statut;
**4.** mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurimin (përditësimin) e rregullt të ueb-faqes;
**5.** koordinojë me KE-në përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Bordit të drejtorëve;
**6.** të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të drejtorëve dhe të Komisionit të auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe do t'i shënojë ato në librat e protokolleve;
**7.** Procesverbali do të përmbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të veçanta të rendit të ditës, tekstin e vendimeve të propozuara, rezultatin e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës),



V. B.

tekstin e saktë të vendimeve të arritura si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e miratuara;
**8.** Procesverbali për mbledhjet e Komisionit komunal të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve, do të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes i Bordit dhe nga sekretari dhe do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhës;
**9.** Procesverbali i mbledhjes do të jetë në dispozicion të aksionarëve dhe drejtorëve, me kërkesën me shkrim;
**10.** Procesverbali i secilës mbledhje të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhës të aksionarëve dhe Bordit të drejtorëve;
**11.** Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të drejtorëve do të nënshkruhet nga ana e kryesuesit të Bordit të drejtorëve dhe do t'u shpërndahet anëtarëve të Bordit të drejtorëve;
**12.** Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe për procesverbalet e Komisionit të auditimit.

## Neni 25
## Detyrat e besuara

**1.** Secili drejtor dhe zyrtar do të kenë detyra për ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë që: të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
**2.** të ushtrojë fuqinë që i'u është dhënë atyre ekskluzivisht, në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;
**3.** të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;
**4.** të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
**5.** të shmangë dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkt apo indirekt) dhe të interesave të shoqërisë;
**6.** të ushtrojë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre;
**7.** të trajtojë si konfidenciale të gjitha informatat e pranuara me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

## Neni 26
## Veprimet e Bordit pa mbajtjen e mbledhjes

Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkohet që një aktivitet i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të Bordit:

**1.** të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e Bordit mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes, nëse pëlqimi me shkrim, që përmban edhe natyrën e aktivitetit përkatës, nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje,
**2.** të gjitha këto pëlqime duhet të përmbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarrë, si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve,
**3.** të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin e mbledhjes së Bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.
**4.** pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.



V.B

**Neni 27**
**Komisionet e bordit**

1. Bordi i drejtoreve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton, kur mund të miratojnë themelimin e një ose më shumë komisioneve, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve) që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo-obligative, që janë në kuadër të kompetencës së Bordit.
2. Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e Bordit të drejtorëve dhe të punësuarit e shoqërisë, si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcaktimit në rregullore.
3. Miratimi i rregulloreve për marrjen e vendimeve të Bordit kërkon një numër më të madh, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit, me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

## II. DISPOZITAT E VEÇANTA

**Neni 28**
**Transparenca**

1. Pas çdo takimi të Bordit të drejtorëve do të lëshoj një raport të shkurtë të hartuar qartë, duke vënë në pah një përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme dhe rekomandimeve të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet sekret i arsyeshëm; informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur sekretin.
2. Bordi i drejtorëve dhe Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj, hartonë një raport të shkurtër, të qartë, që nxjerr në pah të gjitha rastet në të cilat cilido drejtor apo zyrtar ka deklaruar ekzistimin e konfliktit potencial të interesave dhe ka abstenuar – përmbajtur nga votimi ose nga veprimi, duke dhënë indikacione për natyrën e interesave dhe vendimet vepruese për shkak të cilave janë ngritur ato. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziton nevoja për konfidencialitet. Informacioni në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të drejtorit apo zyrtarit përkatës.
3. Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo 3 (tre) muaj, harton raport të shkurtë e të qartë, duke nxjerr në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura, të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mosmiratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar, duke paraqitur vlerën e transaksioneve; vlerën e bilanceve të papaguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garancionet; provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e pranuara gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të pa-pagueshme) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse të ndërlidhura), si dhe deklarata se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për kompaninë.
4. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahen, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të kompanisë, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme, kur më nuk ekziton nevoja për konfidencialitet. Informacioni në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të palës përkatëse të ndërlidhur.

**5. Ndërmarrja do të krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të azhurojë, në përgjegjësinë e KE-së dhe sekrtarit të përgjithshem, 1, (një) ueb–faqe, ku do të paraqiten së paku këto informacione:**

5.1 Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raporti për dokumentet e tilla nga Komisioni i auditimit;

**5.2** Raportin nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me NPL;
**5.3** Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet të fundit. Atëherë kur ndërmarrja të veproj në një treg garues, ajo mund të fshijë nga shpalosjet e tilla të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet;
**5.4** Regjistrin e linjave urbane dhe numrin e operatorve
**5.5** Publikimi i të gjitha akteve Ligjore dhe aktet tjera nën Ligjore që rregullojn fushëveprimtarin e ndërmarrjes publike lokale;
**5.6** Listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjellë;
**5.7** Listën e dhjetë (10) furnizuesve më të rëndësishëm të ndërmarrjes, me çmimet e furnizimeve;
**5.8** Rendin dhe nisjet e të gjitha relacioneve në të gjithë territorin e Komunës së Drenasit (Gllogocit).
**5.9** Çfarëdo padie në gjyq apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve ose zyrtarëve, apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të drejtorëve;
**5.10** Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shpërndahen në paragrafë të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'iu qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të përfshihet në një paragraf të vetëm të ueb – faqes, e cila i dedikohet shpalosjeve publike për çështjet e korporatës dhe do të vendosët në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet leht, secila nga këto në një format që mund të printohet lehtë.

**Neni 29**
**Detyrimi për mos konkurrencë**

Zyrtarët dhe drejtorët nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes. Kjo konkurrencë përfshinë por nuk kufizohet vetëm në punësimin, të qenit ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.

**Neni 30**
**Miratimi i Statutit, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit**

Ndërmarrja mund të miratojë statut të ri nëse ndryshimi i statutit bëhet mbi 50%, të bëjë ndryshimin, plotësimin, apo ta ndryshojë dhe plotësojë atë me qëllim të harmonizimit të tij me dispozitat e ligjit apo akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**Neni 31**
**Likuidimi i ndërmarrjes**

Likuidimi i ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar me nenin 210 të Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018".



V. B

**Neni 32**
**Ushtrimi i detyrimeve sipas vendimit personal ose të gjykatës**

**1.** Aksionarët kanë të drejtë të paraqesin padi në gjykatë në emrin e ndërmarrjes kundër një ose më shumë drejtorëve ose zyrtarëve, nëse këta aksionarë kanë arsye bindese për të besuar se zyrtarët dhe drejtorët përkatës kanë shkelur detyrën ndaj ndërmarrjes dhe me këtë e kanë dëmtuar ndërmarrjen.

**2.** Ankesat e paraqitura në këtë mënyrë duhet të përshkruajnë në hollësi ose (i) përpjekjet që janë bërë nga aksionarët për ta shtyrë Bordin e drejtorëve që ta paraqesë ankesën në emër të ndërmarrjes ose (ii) një deklaratë se këto përpjekje nuk janë ngase do të kishin qenë të padobishme, së bashku me një deklaratë ku paraqiten arsyet për mbështetjen e kësaj deklarate.

**3.** Nëse aksionarët ankues janë të suksesshëm në këtë rast, të gjitha kompensimet e dhëna dhe të pranuara janë pronë e ndërmarrjes.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË HYRJES NË FUQI

**Neni 33**
**Dispozitat kalimtare**

**1.** Për çfarë nuk është thën në Statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 maj 2018", të Ligjit Nr-04/L-111, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/15, qershor 2012", për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/15, qershor 2008", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligji Nr. 05/L -009 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 07 maj 2015".

**2.** Harmonizimi i të gjitha rregulloreve të ndërmarrjesë publike lokale dhe akteve tjera të ndërmarrjesë me këtë Statut, duhet të bëhet në afat prej 3, (tre) muajsh nga dita e miratimit të këtij Statuti.

**3.** Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

**Neni 34**
**Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës**

Rregullorja për organizmin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Ndermarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Drenas (Gllogoc), përmban pjesën mbi organizimin e brendshëm dhe organogramin përkatës dhe sistematizimin e zyrtareve të ndërmarrjesës së lartcekur.

**Neni 35**
**Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve, ky Statut hyn në fuqi 8, (tetë) ditë dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Ndermarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Drenas (Gllogoc).



V.B

KOMISION I KOMUNAL I AKSIONARËVE

**Nr.____________**
**Me datë ______________**

1. **Kryesuesi __________________**
2. **Anëtari________________**
3. **Anëtari_____________**

**VËREJTJE:** Pjesë e këtij statuti është edhe Organogrami apo struktura organizative e Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A.- në Drenas (Gllogoc).



V.B.

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. NË DRENAS (GLLOGOC)



2022

# Raporti i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028

## Periudha raportuese – viti 2020-2021

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I GLLOGOCIT 2020-2028

# Raporti i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028

**Periudha raportuese – viti 2020-2021**

Emërtimi i planit:

**Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028**

Komuna raportuese:

**Gllogoc**

Vendi dhe data:

**Gllogoc, Qershor 2022**

# HYRJE

Komuna e Gllogocit me anë të vendimit të kuvendit komunal 12-Nr-350-6540 me datë 31.01.2018, merr vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ndërsa me vendim të kuvendit komunal 12-Nr-400/01-28767 në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2020 merret vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Për zbatimin e PZHK-së 2020-2028 caktohet përgjegjëse Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Plani i Veprimit të PZHK-së është një kornizë me të cilën përcaktohet zbatimi i masave/veprimeve/projekteve të propozuara në fushat tematike për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara me plan. Identifikimi i veprimeve është bërë gjatë procesit të zhvillimit të PZHK-së, të cilat përfundimisht janë plotësuar dhe azhurnuar për tu ndërlidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës. Për secilin projekt janë përcaktuar bartësit/institucionet përgjegjëse për zbatim, partnerët e mundshëm, vlera financiare e parashikuar, kohëzgjatja e zbatimit dhe burimi i financimit. Gjithashtu janë përcaktuar edhe treguesit përkatës përmes të cilëve do të monitorohet zbatimi i tyre.

Veprimet/projektet e propozuara në PZHK janë grupuar në tri faza të zhvillimit:

- Faza I: periudhën 2020 – 2022 ku kryesisht janë të përfshira projektet /veprimet afatshkurta të cilat edhe janë të ndërlidhura me kornizën afatmesme të planifikimit buxhetor komunal;
- Faza II: periudhën 2022-2024 dhe i përfshin veprimet/projektet afatmesme;
- Faza III: periudhën 2025-2028 dhe përfshin veprimet/projektet afatgjata.

# Përmbledhje e shkurtë e Pzhk-së

## VIZIONI

*"Të gjitha rrugët kalojnë nëpër Gllogoc".*
*Në zemër të Kosovës, Gllogoci me ekonomi të bazuar në zhvillim të qëndrueshëm rural, përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale.*
*Banim e shërbime cilësore, ku qytetari është në qendër të vëmendjes e rinia e aftësuar profesionalisht;*
*Mjedis të qëndrueshëm e shfrytëzim racional të resurseve natyrore, promovim të trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit.*

### QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

ZHVILLIMI EKONOMIK

**Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit të bujqësisë**

Objektiva 1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore

Objektiva 1.2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë

Objektiva 1.3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite

Objektiva 1.4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite

**Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)**

Objektiva 2.1. Rritja e bizneseve prodhuesve për 6% në çdo vit

**Qëllimi 3: Ngritja e kualitetit te veprimtarive shërbyese**

Objektiva 3.1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese

**Qëllimi 4: Nxitja e zhvillimit të turizmit rural**

Objektiva 4.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit

Objektiva 4.2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite)

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: ENERGJETIKA

**Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme.**

Objektiva 1.1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KË) nga përçuesit ajror në atë kabllore, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 1.2. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme deri në 5%, ne 8 vitet e ardhshme

Objektiva 1.3. Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: UJËSJELLËSI, KANALIZIMI DHE UJITJA

**Qëllimi 2: Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes**

Objektiva 2.1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme

Objektiva 2.2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc)

Objektiva 2.3. Trajtimi i ujërave të zeza për 50% të territorit në 5 vitet e ardhshme

Objektiva 2.4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfiguracioni i terrenit e lejon

Objektiva 2.5. Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: MBETURINAT

**Qëllimi 3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës**

Objektiva 3.1. Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme

## INFRASTRUKTURA TEKNIKE: TRANSPORT

**Qëllimi 4: Sigurimi i transportit të integruar për komunën e Gllogocit**

Objektiva 4.1. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit

Objektiva 4.2. Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit

Objektiva 4.3. Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikëlit brenda 3 viteve

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: ARSIMI

**Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë**

Objektiva 1.1. i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025)

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: SHËNDETËSIA

**Qëllimi 2: Ofrimi I shërbimeve cilësore të shëndetësisë me zhvillim të vazhdueshëm profesional**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale

## INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE: KULTURA, SPORTI, HAPËSIRAT PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E GJELBRA

**Qëllimi 3: Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra**

Objektiva 3.1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale ne 5 nën qendrat e komunës (deri ne 2025)

Objektiva 3.2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë

Objektiva 3.3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri ne vitin 2030

## MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIK

**Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë**

Objektiva 1.1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021)

Objektiva 1.2. Monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025

Objektiva 1.3 Pyllëzimi si masë anti-ndotëse deri në vitin 2027

**Qëllimi 2. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv**

Objektiva 2.1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Pastrimi dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021

Objektiva 2.3 Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masë antierozive deri në vitin 2027

Objektiva 2.4 Pastrimi dhe rikultivimi i zonave të degraduara nga veprimtaritë eksploatuese të drurit dhe gurëve apo nxjerrja e zhavorrit

**Qëllimi 3. Sigurimi i një mjedisi më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë**

Objektiva 3.1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2025

**Qëllimi 4: Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**

Objektiva 4.1. Konzervimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024

Objektiva 4.2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023

VENDBANIMET

**Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës**

Objektiva 1.1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit

Objektiva 1.2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje

**Qëllimi 2: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime**

Objektiva 2.1. Ofrimi I shërbimeve dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022

Objektiva 2.2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve

Objektiva 2.3. Rregullimi i çështjeve pronësore

BANIMI

**Qëllimi 1: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues të banimit**

Objektiva 1.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar

Objektiva 1.2. Evidentimi dhe futja ne shfrytëzim e 80% të kapaciteteve të pashfrytëzuara të banimit deri në 2025

Objektiva 1.3. Rritja e efiçiencës energjetike 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030

**Qëllimi 2: Plotësimi i nevojave për banim**

Objektiva 2.1. Sigurimi i banimit adekuat për 10% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022

Objektiva 2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri ne vitin 2022

## PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT

| Qëllimi | Poena |
|---|---|
| **Vendbanimet** - Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës | 61 |
| **Zhvillimi ekonomik** | 59 |
| Qëllimi 2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM) | |
| **Ujësjellësi, kanalizimi dhe ujitja** | 54 |
| Qëllimi 2: Zhvillimi I infrastrukturës se ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes | |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)** | 39 |
| Qëllimi 1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë | |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Arsimi)** | 24 |
| Qëllimi 1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë | |
| **Zhvillimi ekonomik** - Qëllimi 1: Nxitja e zhvillimit te bujqësisë | 23 |
| **Mirëqenia sociale** - Qëllimi 3: Përmirësimi i mirëqenies sociale | 11 |
| **Mbeturinat** - Qëllimi 3: Përmirësimi I sistemit te menaxhimit te mbeturinave te tere territorin e komunës | 11 |
| **Infrastruktura teknike (Energjetika)** | 10 |
| Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve për furnizim te qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme. | |
| **Trashëgimia kulturore dhe natyrore** - Qëllimi 4: Krijimi i qasjes se integruar në mbrojtje te trashëgimisë kulturore dhe natyrore | 10 |
| **Infrastruktura publike dhe sociale (Shëinndetësia)** - Qëllimi 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore te shëndetësisë me zhvillim te vazhdueshëm profesional | 9 |

| | |
|---|---|
| **Infrastruktura sociale – Kultura, sporti, hapesirat publike dhe hapesirat e gjelbra** Qellimi 4: Ngritja e infrastruktures per objektet e kultures, sportit dhe rritja e hapesirave publike dhe te gjelbra | **6** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)** - Qëllimi 3: Sigurimi i një mjedisi me te sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera | **6** |
| **Transporti** - Qellimi 4: Sigurimi I transportit të integruar për komunën e Gllogocit | **5** |
| **Zhvillimi ekonomik** - Qëllimi 3: Zhvillimi i resurseve njerëzore ne përputhje me kërkesat e tregut | **5** |
| **Banimi** - Qëllimi 2: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues te banimit | **4** |
| **Banimi** - Qëllimi 3: Plotësimi i nevojave për banim | **4** |
| **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik (Mjedisi)** - Qëllimi 2: Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv | **3** |
| **Vendbanimet** - Qëllimi 1: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime | **1** |

# Raporti mbi rezultatet e zbatimit të PZHK-së

Me qëllim të monitorimit të zbatimi të aktiviteteve të Pzhk-së, dhe duke u bazuar në planin e veprimit, konkretisht në kohëzgjatjen e implementimit të tyre në këtë raport janë paraqitur vetëm veprimet/projektet/programet të cilat janë kategorizuar si afatëshkurt dhe në vazhdimësi.

**Plani i veprimit – Zhvillimi ekonomik**

- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese së tokës bujqësore për shfrytëzim
- Fushatë vetëdijesimi dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore
- Drenazhimi i tokave bujqësore (10% e tokës bujqësore në vit kalendarik)
- Ndalimi i ndërtimeve në tokën bujqësore (sidomos nën komasacion)
- Hapja e drejtimit të bujqësisë në kuadër të shkollës profesionale (përfshirë edhe hapësirat për punë praktike)
- Stimulimi i drejtimit bujqësisë përmes bursave për student
- Trajnimi i mësimdhënësve për këshillim dhe orientim në karrierë për të rinjtë
- Zhvillimi i skemave të subvencioneve dhe grante për përkrahjen e sektorit të blegtorisë
- Nxitja e organizimit te blegtorëve në kooperativa apo shoqata
- Hartimi i një programi për rritjen e prodhimit të frutave/perimeve/bimëve mjekësore dhe aromatike
- Edukimi i vazhdueshëm i fermerëve përmes Qendrës informuese këshilluese
- Krijimi sektorit përgjegjës për promovim të investimeve
- Krijimi dhe funksionalizimi i bashkëpunimit ndërkomunal për plasim të produkteve dhe prodhim
- Partneriteti me sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese me qellim te trajnimit te vazhdueshëm në këtë sektor
- Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve promovuese vendore dhe regjionale

**Plani i veprimit – Infrastruktura teknike**

- Punimi i studimit te fizibilitetit për ngrohjen qendrore me kogjenerim nga termocentralet apo Ferronikeli
- Ndërrimi i rrjetit te azbestit ne qendër të qytetit me gjatësi ~ 5000 m
- Hartimi i studimit të fizibilitetit (duke përfshirë hulumtimin e sasisë së ujit) për ndërtimin e pendës si dhe ndërtimi i pendës në Verbovc
- Ndërtimi i impianteve të pastrimit të ujërave të zeza me kapacitete të vogla për ato pjesë ku rrjedhat e ujit nuk janë në drejtim të lumit Drenica
- Mbulimi i sipërfaqeve të punueshme në sistem të ujitjes .
- Monitorimi dhe rehabilitimi i lokacioneve në të cilat janë eliminuar deponitë ilegale (72 lokacione)
- Identifikimi i vendeve të cilat nuk janë të përfshira në transport dhe dhënia e lejeve të operimit për transport të udhëtarëve
- Hartimi i planit të mobilitetit
- Vendosja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në rrugë lokale dhe në nënkalimet në hekurudhë.
- Caktimi i rrugëve për kalimin e mjeteve transportuese mbi pesha 7.5 si dhe mbjellja e drunjtëve

**Plani i veprimit - Infrastruktura teknike dhe sociale**

- Plotësimi me pajisje të teknologjisë informative dhe kabineteve laboratorike i të gjitha shkollave
- Ndërtimi i shkollave, çerdheve dhe kopshteve plotësuese në Gllogoc, Komoran, Baicë, Tërstenik, Gllanasellë, Arllat dhe Sankoc
- Ofrimi i trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit
- Ofrimi trajnimeve të avancuara dhe hartimi I rregulloreve për stafin shëndetësor
- Ngritja e cilësisë fizike në objektet shëndetësore (Parkingje, rrethoja, hapësira të gjelbra etj.) si dhe furnizimi me barëra
- Sigurimi i akomodimit për banim social (çdo vit kalendarik nga 5 familje)

**Plani i Veprimit - Mjedisi, sipërfaqet me rrezikshmëri, trashëgimia natyrore dhe kulturore**

- Vendosja e matësve për matjen e cilësisë së ajrit në Gllobar, Dobroshec, si dhe ne afërsi te Ferronikelit
- Vendosja e TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme në qytet
- Monitorimi i vazhdueshëm nga institucionet përgjegjëse
- Monitorimi i lumit Drenica, në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklekut dhe Çikatovë të Vjetër (vendosja e matësëve të nivelit të ujit)
- Monitorimi i përfundimit të vendosjes së gjeo-membranës në gropën e skories në krijim në Çikatovë të vjetër, sipas lejes mjedisore të Ferronikelit
- Konzervimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkitekturore (kulla, shtëpi, kompleks banimi) në komunën e Gllogocit
- Konzervimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkeologjike (kala, fortifikatë, tuma) në komunën e Gllogocit
- Organizmi dhe implementimi i fushatave vetëdijesuese për trashëgiminë kulturore në nivel komunal

**Plani i veprimit – Vendbanimet**

- Fuqizimi i aplikimit të gjobave për ndërtimet e objekteve pa leje sipas legjislacionit ne fuqi

**Plani i veprimit – Banimi**

- Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për „ndërtesat e pabanuara" në tërë territorin e Gllogocit
- Themelimi i bashkëpunimit me MF për vendosjen e tatimit të rritur për njësitë banesore të pabanuara
- Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet qe krijohen me aplikimin e masave efiçciente ne objektet e banimit
- Krijimi dhe menaxhimi i fondit për banim të përballueshëm

## Plani i veprimit të Planit Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028

| FUSHA TEMATIKE | KODI I PROJEKTIT | VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE TJERA TË PËRFSHIRA | PRIORITETET | KOHËZGJATJA | IMPLIKIMET FINANCIARE | INDIKATORËT | Realizuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ZHVILLIMI EKONOMIK | QËLLIMI 1: NXITJA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore | | | | | | | | |
| | A1 | Vlerësimi i gjendjes ekzistuese së tokës bujqësore për shfrytëzim | DGJKP, DU, DB | Komun a | Lartë | Afatshkurtër | 8,000 | Raporti i hartuar<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | JO |
| | A2 | Fushatë vetëdijesimi dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore | Komuna | Ministri t | Lartë | Afatshkurtër-Një Vjeçare | 10,000 | Raporti nga fushata<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | PO |
| | A3 | Drenazhimi i tokave bujqësore<br>(10% e tokës bujqësore në vitë kalendarik) | Komuna | Donato ret | Lartë | Vazhdimësi | 250,000 | Projektet e zbatuara<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | JO |
| | A5 | Ndalimi i ndërtimeve në tokën bujqësore (sidomos nën komasacion) | Komuna | MIA, MBZHR | Lartë | Vazhdimësi | 1,000 | Raporti i monitorimit te PZHK-së | PO |
| | Objektiva 1.2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë | | | | | | | | |
| | A1 | Hapja e drejtimit të bujqësisë në kuadër të shkollës profesionale (përfshirë edhe hapësirat për punë praktike) | Komuna , DKA | MASHT | Lartë | Afatshkurtër | 10,000 | Kurrikula shkollore<br>Raportet vjetore të regjistrimit | JO |
| | A2 | Stimulimi i drejtimit bujqësisë përmes bursave për student | Komuna , DKA | Biznese t | Lartë | Vazhdimësi | 10,000 | Raportet e Drejtorisë së Arsimit<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | JO |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A4 | Trajnimi i mësimdhënësve **për** këshillim dhe orientim në karrierë për të rinjtë | Komuna | MASHT<br>Donatorët | Lartë | Vazhdimësi | 10,000 | Trajnimi i realizuar<br>Raportet e Drejtorisë së Arsimit | PO |
| | Objektiva 1.3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite | | | | | | | | |
| | A2 | Zhvillimi i skemave të subvencioneve dhe grante për përkrahjen e sektorit të blegtorisë | Komuna -DB | MBZHR, Donatorët, OJQ | Lartë | Vazhdimësi | 100,000 | Grantet e shpërndara<br>Raportet e Drejtorisë së Bujqësisë<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | PO |
| | A6 | Nxitja e organizimit te blegtorëve në kooperativa apo shoqata | Komuna -DB, OJQ | MBZHR Donatoret | Lartë | Afatshkurtër | 7,500 | Kooperativa e themeluar<br>Raportet e Drejtorisë së Bujqësisë<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | NE PROCES |
| | Objektiva 1.4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite, | | | | | | | | |
| | A1 | Hartimi i një programi për rritjen e prodhimit të frutave/perimeve/bimëve mjekësore dhe aromatike | Komuna -DB | Fermerët,<br>Donatorët<br>OJQ | Lartë | Afatshkurtër | 5,000 | Programi i hartuar<br>Raportet e Drejtorisë së Bujqësisë<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | PO |
| | A5 | Edukimi i vazhdueshëm i fermerëve përmes Qendrës informuese këshilluese | Komuna -DB | MBZHR, Donatorët | Mesëm | Vazhdimësi | 50,000 | Trajnimi i realizuar<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | PO |
| | **QËLLIMI 2: NXITJA E BIZNESEVE PRODHUESE DHE PËRPUNUESE (NVM)** | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.1. Rritja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese për % në çdo vit (NVM) | | | | | | | | |
| | A3 | Krijimi sektorit përgjegjës për promovim të investimeve | Komuna -DZHE | Donatorët | Lartë | Vazhdimësi | 8,000 | Raportet e Drejtorisë për ZHE<br>Raportet e Drejtorisë për Financa | JO |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A4 | Krijimi dhe funksionalizimi i bashkëpunimit ndërkomunal për plasim të produkteve dhe prodhim | Komuna, dhe Komunat fqinje | RDA-Qendër | Lartë | Vazhdimësi | 1,000 | Memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar dhe në zbatim | JO |
| | **QËLLIMI 3: NGRITJA E KUALITETIT TE VEPRIMTARIVE SHËRBYESE** | | | | | | | | |
| | Objektiva 3.1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese | | | | | | | | |
| | A2 | Partneriteti me sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese me qellim te trajnimit te vazhdueshëm në këtë sektor | Komuna -DZHE | MZHE, Donatorët | Ulët | Vazhdimësi | 4,000 | Raportet e Drejtorisë për ZHE<br>Memorandumi i nënshkruar | JO |
| | **QËLLIMI 4: NXITJA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT RURAL** | | | | | | | | |
| | Objektiva 4.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit | | | | | | | | |
| | Objektiva 4.2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite) | | | | | | | | |
| | A2 | Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve promovuese vendore dhe regjionale | Komuna | MZHE, | Lartë | Vazhdimësi | 10,000 | Aktivitetet organizuara<br>Raportet e Drejtorisë për ZHE dhe Drejtorisë për Financa | JO |
| INFRASTRUKTURA TEKNIKE | **QËLLIMI 1: RRITJA E KAPACITETEVE PËR FURNIZIM TË QËNDRUESHËM ME ENERGJI DUKE PËRDORUR EDHE BURIMET E RIPËRTRITSHME** | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KË) nga përçuesit ajror në atë kabllore, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.3. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme deri në 5%, ne 8 vitet e ardhshme | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.4 Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore | | | | | | | | |
| | | Punimi i studimit te fizibilitetit për ngrohjen qendrore me kogjenerim nga termocentralet apo Ferronikeli | Komuna -DSHPE | | Lartë | Afatshkurtë | 5,000 | Studimi i fizibilitetit i perfunduar | NE PROCES |
| | **QËLLIMI 2: ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT (FEKAL DHE ATMOSFERIK) SI DHE UJITJES** | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme | | | | | | | | |
| | A2 | Ndërrimi i rrjetit te azbestit ne qendër të qytetit me gjatësi ~ 5000 m | KRU Prishtina | Komuna-DDUMM | Lartë | Afatshkurtë | 50,000 | Rrjeti i azbestit i ndërtuar | PO |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektiva 2. 2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc) | | | | | | | | | |
| A1 | Hartimi i studimit të fizibilitetit (duke përfshirë hulumtimin e sasisë së ujit) për ndërtimin e pendës si dhe ndërtimi i pendës në Verbovc | Privat, MIA | Komun a-DI | Lartë | Afatshkurtë | 750,000 | Studimi i fizibilitetit i hartuar dhe penda e ndërtuar | PO |
| Objektivi 2.3 Trajtimi i ujërave të zeza për 50% të territorit në 5 vitet e ardhshme | | | | | | | | | |
| A1 | Ndërtimi i impianteve të pastrimit të ujërave të zeza me kapacitete të vogla për ato pjesë ku rrjedhat e ujit nuk janë në drejtim të lumit Drenica | MIA | Komun a-DSHP | Lartë | Afatshkurtë | 500,000 | Impiante me kapacitete të vogla të ndërtuara | JO |
| Objektivi 2.4 Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfiguracioni i terrenit e lejon | | | | | | | | | |
| Objektivi 2.5 Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional | | | | | | | | | |
| A1 | Mbulimi i sipërfaqeve të punueshme në sistem të ujitjes | Komuna | KRU Prishtin a | Lartë | Afatshkurtë | 500,000 | Tokat bujqësore të mbuluara me sistem të ujitjes | PO |
| **QËLLIMI 3: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS** | | | | | | | | | |
| Objektivi 3.1 Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme | | | | | | | | | |
| A3 | Monitorimi dhe rehabilitimi i lokacioneve në të cilat janë eliminuar deponitë ilegale (72 lokacione) | Komuna , NP Pastrimi | Donato r | Lartë | Vazhdimësi | 75,000 | Të gjitha deponitë të rehabilituara | PO |
| **QËLLIMI 4. SIGURIMI I TRANSPORTIT TË INTEGRUAR PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT** | | | | | | | | | |
| Objektiva 4.1 Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit | | | | | | | | | |
| A1 | Identifikimi i vendeve të cilat nuk janë të përfshira në transport dhe dhënia e lejeve të operimit për transport të udhëtarëve | Komuna -DSHPE | Komun a-DI | Lartë | Afatshkurtë | 4,500 | Vendbanimet të përfshira në transport publik, kriteret komunale dhe ligjore për transport të udhëtarëve | PO |
| A5 | Hartimi i planit të mobilitetit | Komuna | Komun a- DSHPE | Mesëm | Afatshkurtë | 10,000 | Plani i hartuar | JO |
| Objektivi 4.2 Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A2 | Vendosja e sinjalizimit vertika dhe horizontal në rrugë lokale dhe në nënkalimet në hekurudhë. | Komuna | Komuna-DSHPE | Lartë | Afatshkurtë | 10,000 | Sinjalizimet e vendosura | PO |
| | Objektiva 4.3 Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikëlit brenda 3 viteve | | | | | | | | |
| | A1 | Caktimi i rrugëve për kalimin e mjeteve transportuese mbi pesha 7.5 si dhe mbjellja e drunjëve | Komuna | Komuna-DSHPE | Lartë | Afatshkurtë | 450,000 | rrugët sekondare të finalizuara | PO |
| INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE | **QËLLIMI 1: SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR TË PËRSHTATSHËM PËR TË GJITHË** | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.1. Kompletimi i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025) | | | | | | | | |
| | A1 | Plotësimi me pajisje të teknologjisë informative dhe kabineteve laboratorike i të gjitha shkollave | Komuna | MASHT | Lartë | Vazhdimësi | 225,000 | Infrastruktura e kompletuar shkollore | PO |
| | A3 | Ndërtimi i shkollave, çerdheve dhe kopshteve plotësuese në Gllogoc, Komoran, Baicë, Tërstenik, Gllanasellë, Arllat dhe Sankoc | Komuna | MASHT | Lartë | Vazhdimësi | 600,000 | Infrastruktura arsimore e kompletuar | PO |
| | A5 | Ofrimi i trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit | Komuna | MASHT | Lartë | Vazhdimësi | 75,000 | Kapacitete të ngritura të stafit profesional | PO |
| | **QËLLIMI 2: OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE TË SHËNDETËSISË ME ZHVILLIM TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL** | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.2. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022 | | | | | | | | |
| | A2 | Ofrimi trajnimeve të avancuara dhe hartimi I rregulloreve për stafin shëndetësor | Komuna -DSHMS | MSH | Lartë | Vazhdimësi | 25,000 | Trajnimet e realizuara | PO |
| | A3 | Ngritja e cilësisë fizike në objektet shëndetësore (Parkingje, rrethoja, hapësira të gjelbra etj.) si dhe furnizimi me barëra | Komuna | MSH | Mesëm | Vazhdimësi | 250,000 | Kushte të përmirësuar në objekte shëndetësore | PO |
| | Objektiva 2.3. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale | | | | | | | | |
| | A1 | Sigurimi i akomodimit për banim social (çdo vit kalendarik nga 5 familje) | Komuna | MPMS | Mesëm | Vazhdimësi | 175,000 | Strehimi i banorëve të pastrehë | PO |
| | **QËLLIMI 3: NGRITJA E INFRASTRUKTURËS PËR OBJEKTET E KULTURËS, SPORTIT, DHE RRITJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE TË GJELBRA** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Objektiva 3.1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale ne 3 nën qendrat e komunës (deri ne 2025) | | | | | | | | |
| | Objektiva 3.2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë | | | | | | | | |
| | Objektiva 3.3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri ne vitin 2030 | | | | | | | | |
| MJEDISI, SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI, TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE | **QËLLIMI: ZVOGËLIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS NGA INDUSTRIA E RËNDË** | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021 | | | | | | | | |
| A1 | Vendosja e matësve për matjen e cilësisë së ajrit në Gllobar, Dobroshec, si dhe ne afërsi te Ferronikelit | MIA | Komuna e Gllogocit | Lartë | ASH | 15,000 | Matës të vendosur në Dobroshec Gllobar dhe rreth Ferronikelit si dhe funksionimi i tyre | NE PROCES | |
| A2 | Vendosja e TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme në qytet | Komuna | OJQ, DOnatorët | Lartë | ASH | 12,000 | TV ekranet e vendosura nëpër min.3 lokacione në qytet | NE PROCES | |
| A3 | Monitorimi i vazhdueshëm nga institucionet përgjegjëse | MIA | OJQ | Lartë | V | 4,500 | Raporte mbi gjendjen e cilësisë së ajrit | PO | |
| | Objektiva 1.2. Monitorimi i rregullt i sasisë së ujit dhe shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025 | | | | | | | | |
| A1 | Monitorimi i lumit Drenica, në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklekut dhe Çikatovë të Vjetër (vendosja e matëseve të nivelit të ujit) | MIA | Komuna, OJQ | Lartë | V | 5,000 | Raporte të hartuara mbi gjendjen e lumit Drenica | NE PROCES | |
| | Objektiva 1.2 Pyllëzimi si masë anti-ndotëse deri në vitin 2027 | | | | | | | | |
| A2 | Monitorimi i përfundimit të vendosjes së gjeo-membranës në gropën e skories në krijim në Çikatovë të vjetër, sipas lejes mjedisore të Ferronikelit | Komuna | | Lartë | ASH | | Raporti i monitorimit | PO | |
| | **QËLLIMI 2. KRIJIMI I NJË MJEDISI TË PASTËR DHE ATRAKTIV** | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022 | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.2. Pastrimi dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021 | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.3 Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masë antierozive deri në vitin 2027 | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Objektiva 2.4 Pastrimi dhe rikultivimi i zonave të degraduara nga veprimtaritë eksploatuese të drurit dhe gurëve apo nxjerrja e zhavorit | | | | | | | | | |
| | **QËLLIMI 3. SIGURIMI I NJË MJEDISI MË TË SIGURT NGA NDIKIMET NGA FATKEQËSITË** | | | | | | | | | |
| | Objektiva 3.1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2027 | | | | | | | | | |
| | Objektiva 3.2 Zvogëlimi i ndikimeve nga zjarri deri në vitin 2025 | | | | | | | | | |
| | **QËLLIMI 4: KRIJIMI I QASJES SË INTEGRUAR NË MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE** | | | | | | | | | |
| | Objektiva 4.1. Konzervimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024 | | | | | | | | | |
| | A1 | Konzervimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkitekturore (kulla, shtëpi, kompleks banimi) në komunën e Gllogocit | MKRS dhe Komuna | Donatorë, OJQ | Lartë | V | 300,000 | Brenda vitit së paku një objekt/intervenim | JO |
| | A2 | Konzervimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkeologjike (kala, fortifikatë, tuma) në komunën e Gllogocit | MKRS dhe Komuna | Donatorë, OJQ | Lartë | V | 300,000 | Brenda vitit së paku një objekt/intervenim | JO |
| | Objektiva 4.2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023 | | | | | | | | | |
| | A1 | Organizmi dhe implementimi i fushatave vetëdijesuese për trashëgiminë kulturore në nivel komunal | Komuna | OJQ | M | V | 10,000 | Trashëgimia e përfshirë në programe shkollare, trajnime | PO |
| VENDBANIMET | **Qëllimi 1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës** | | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit | | | | | | | | | |
| | Objektiva 1.2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje | | | | | | | | | |
| | A1 | Fuqizimi i aplikimit të gjobave për ndërtimet e objekteve pa leje sipas legjislacionit ne fuqi | Komuna | N/A | Lartë | Vazhdimësi | 4,500 | Numri i gjobave të dhëna/ndërtimet pa leje | PO |
| | **QËLLIMI 2: FUQIZIMI I NËN-QENDRAVE ME SHËRBIME** | | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.1. Ofrimi I shërbimeve 5 dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022 | | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve | | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.3. Rregullimi i çështjeve pronësore | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BANIMI | QËLLIMI 1: PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT DHE CILËSISË SË FONDIT EKZISTUES TË BANIMIT<br>Objektiva 1.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar | | | | | | | | |
| | A1 | Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për „ndërtesat e pabanuara" në tërë territorin e Gllogocit | Komuna | MIA, ASK | Lartë | Afatshkurtë | 5,000 | Databaza e krijuar e ndërtesave të pabanuara të banimit | PO |
| | A2 | Themelimi i bashkëpunimit me MF për vendosjen e tatimit të rritur për njësitë banesore të pabanuara | Komuna, MF | MMPF | Mesëm | Afatshkurtë | 5,000 | Bashkëpunimi i themeluar<br>Taksa e rritur për njësitë banesore të pabanuara në fuqi | NE PROCES |
| | Objektiva 1.3. Rritja e efiçiencës energjetike 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030 | | | | | | | | |
| | A1 | Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet qe krijohen me aplikimin e masave efiçciente ne objektet e banimit | Komuna | MZHE, Donator | Mesëm | Vazhdimësi | 15,000 | Numri i kampanjave informuese / Broshurave / Prezantimeve publike | JO |
| | **QËLLIMI 2: PLOTËSIMI I NEVOJAVE PËR BANIM NGA FATKEQËSITË NATYRORE, FAMILJET E DËSHMORËVE DHE TJERA** | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.1. Sigurimi i banimit adekuat për 0% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022 | | | | | | | | |
| | Objektiva 2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri ne vitin 2022 | | | | | | | | |
| | A2 | Krijimi dhe menaxhimi i fondit për banim të përballueshëm | Komuna | Donatorët | Lartë | Afatshkurtë & Vazhdimësi | 225,000 | Fondi i krijuar<br>Nr. i familjeve të strehuara | JO |

Nga tabela e mësipërme shihet se që nga aprovimi i Pzhk-së deri në fundvit 2021 aktivitetet janë realizuar si në vijim:

7 – në proces, 23 – janë realizuar, ndërsa 14 nuk janë realizuar ose nuk ka filluar realizimi i tyre.

## Përfundimi

Komuna e Gllogocit, sikurse te gjitha komunat tjera të Kosovës është përballur me sfida të mëdha gjatë zbatimit të aktiviteteve të planifikuara me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Për realizimin e projekteve ka një numër të madh të faktorëve të cilët duhet të merren parasyshë, disa nga ta janë: Institucioni përgjegjës, subjektet tjera ndihmëse (donatorët), prioriteti, koha e fillimi të implementimit dhe afati i përcaktuar kohor, si dhe kostoja e projektit.

Vitet 2020 dhe 2021 ndryshe janë karakterizuar si vite të pandemisë Covid-19, kohë në të cilën u transformua rrjedha e punëve dhe planifikimit të buxhetit duke u fokusuar me theks të veçantë në krijimin e kushteve dhe mbrojtjes së shëndetit publik, u aplikuan masa strikte të cilat pamundësuan punën normale në institucione e që pati ndikim edhe në realizimin e projekteve të planifikuara.

Organizimi i kampanjave informuese ose prezantimeve publike gjatë vitit 2020 dhe 2021, ka qenë pothuajse i pamundur në rrethana të pandemisë Covid-19, dhe si rrjedhojë e mosmbajtjes së tyre disa nga projektet/aktivitetet e parapara sipas planit të veprimit nuk janë realizuar sipas parashikimit.

Krijimi i partneriteteve dhe hapja e sektorëve të rinjë për promovim dhe menaxhim të investimeve kërkon kohë, personel të kualifikuar dhe ka implikime financiare. Duke iu referuar problematikave të përmendura më lartë, hartimi i propozim-projekteve, gjetja e donatorëve dhe situata me pandeminë, problemet gjatë ekzekutimit të projekteve kanë qenë sfida të cilat e karakterizuan periudhën për të cilën është hartuar ky raport.